



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 803/ 5 prot.

Datë 09.04.2025

**V E N D I M**  
**Nr.454/2025**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

|                  |            |
|------------------|------------|
| Jonaid Myzyri    | Kryetar    |
| Fiorent Zguro    | Nënkryetar |
| Kreshnik Ternova | Anëtar     |
| Anila Malaj      | Anëtar     |
| Gjergj Mersini   | Anëtar     |

Në mbledhjen e datës 09.04.2025 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Optima Communication” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-41494-03-18-2025, me objekt “Shërbim për zhvillimin e strategjisë së komunikimit dhe marketingut me publikun”, me fond limit: 14,873,333.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 03.04.2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Albpetrol

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit.

**Ankimues:**

Operatori ekonomik “Optima Communication” SHPK me NIPT K71903025A dhe adresë: Rruga Shyqyri Berxolli, Pallati Inter Co-Sat, Seksioni B, Kati i 6-të, Nr. 6/5, Dera 28B, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:**

Sh.A Albpetrol, me adresë: Selia, Rruga Fier – Patos, km 7

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:****I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

## II

### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 19.03.2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-41494-03-18-2025, me objekt “Shërbim për zhvillimin e strategjisë së komunikimit dhe marketingut me publikun”, me fond limit: 14,873,333.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 03.04.2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Albpetrol.

II.2. Me datë 25.03.2025 njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike është paraqitur ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/5183 e operatorit ekonomik “Optima Communication” SHPK duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesit, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Me datë 02.04.2025 autoriteti kontraktor ka ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike vendimin e KSHA për shqyrtimin e ankesës me nr. 1558/2 prot., datë 01.04.2025 i cili u protokollua me tonën me nr. 803/1 prot., datë 02.04.2025 ku e ka pranuar pjesërisht atë, si më poshtë vijon:

“

## II

### VENDIM

*Mbi ankesën e paraqitur nga OE “OPTIMA COMMUNICATION” shpk KSHA, pasi shqyrtoi paraprakisht ankesën e paraqitur nga OE “OPTIMA COMMUNICATION” shpk për dokumentet e tenderit me objekt: “Shërbim për zhvillimin e strategjisë së komunikimit dhe marketingut me publikun” me REF-41494-03-18-2025, me fond limit 14,873,333 (katërmbëdhjetë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar nga AK, “Albpetrol” SH.A, më datë 03.04.2025, Ora:10.00, si dhe materialin e vënë në dispozicion nga Njësia e Prokurimit,*

### VËREN:

*Rrethanat e faktit: – OE “OPTIMA COMMUNICATION” shpk ka paraqitur, nëpërmjet sistemit elektronik të Komisionit të Prokurimit Publik, ankesë me objekt:*

- Modifikim i dokumenteve të tenderit me objekt: “Shërbim për zhvillimin e strategjisë së komunikimit dhe marketingut me publikun” me REF-41494-03-18-2025.*
- Ankesa është regjistruar nëpërmjet sistemit online të KPP, brenda afateve ligjore që parashikon neni 110 i LPP, dhe, si e tillë, duhet të shqyrtohet në themel.*

Në Seksionin III. Përshkrimi i ankesës, 1. Baza Ligjore, ankuesi përshkruan:

- Ligji 162/2020 - Për Prokurimin Publik (më poshtë referuar LPP) - VKM Nr. 285, datë 19.5.2021

- Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik duke zgjedhur si objekt të ankesës opsionin:

- Modifikim i dokumenteve të tenderit.

1. Ankimuesi arsyeton si më poshtë

#### PIKA 1

Në shtojcën 6 FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE dhe në shtojcën 8 FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS, përshkruhet: Përshkrimi sasior i shërbimeve që kërkohen: Realizim i 1 (një) video të përgjithshme korporative për shoqërinë “Albpetrol” SH.A.

Realizim i 5 (pesë) videove informuese lidhur me 5 vendburimet e prodhimit të naftës që janë në administrim të “Albpetrol” SH.A.

Realizim i 5 (pesë) videove informuese dhe promovuese të Reparteve Prodhuese dhe Shërbimeve të “Albpetrol” SH.A.

Realizim i arkivit të përmbajtjes vizuale dhe multimediale për marketingun digital dhe rrjetet sociale për t'u përdorur në të gjithë harkun kohor të 1 (një) viti ku përfshihen:

➤ 30 video montazhe

➤ 100 fotografi profesionale

➤ 120 designe për postime

Kjo përmbajtje do të përfshijë: Përdorimi i Stories dhe Highlights për të krijuar kategori të veçanta, si Mjedis, Teknologjia e Re, Punonjësit Tanë dhe “Dita në jetën e punonjësve tanë”. Hartimi i Strategjisë së Marketingut Dixhital të shoqërisë “Albpetrol” SH.A.

Po në këto dy shtojca, si edhe në shtojcën 7 FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT, paraqitet lista e produkteve:

Nr Përshkrimi Sasia (Copë)

Realizim i videos të përgjithshme korporative për shoqërinë “Albpetrol” SH.A. 1 Realizim i videove informuese lidhur me 5 vendburimet e prodhimit të naftës që janë në administrim të “Albpetrol” SH.A. 5

Realizim i videove informuese dhe promovuese të Reparteve Prodhuese dhe Shërbimeve të “Albpetrol” SH.A. 5

Realizim i arkivit të përmbajtjes vizuale dhe multimediale për marketingun digital dhe rrjetet sociale për t'u përdorur në të gjithë harkun kohor të 1 (një) viti ku përfshihen:

1 30 video montazhe 30

100 fotografi profesionale 100

120 designe për postime 120

#### PROBLEMATIKA 1.1

Brenda ketyre shtojcave ka mosperputhje. Në pikën A: “Përshkrimi sasior i shërbimeve që kërkohen” renditen 5 (pesë) shërbime. Në tabelat me zera të procedurave renditen 4 (kater) shërbime. Shërbimi i pestë “Hartimi i Strategjisë së Marketingut Dixhital të shoqërisë “Albpetrol” SH.A” nuk është i përfshirë në tabelën e produkteve të procedurave, dhe as nuk jepen sqarime apo specifikime për këto pike. Lutemi na sqaroni nëse kërkohet që të ofertojmë për

*“Hartimi i Strategjisë së Marketingut Dixhital të shoqërisë “Albpetrol” SH.A” apo jo. Nese po lutemi shtojeni kete ze ne listen e produkteve te procedures, si edhe jepni specifikimet perkatese sikurse i keni dhene per te gjitha zerat e tjere. Lutem referojuni llogaritjes qe keni bere per fondin limit, si e keni llogaritur fondin per piken 5, cfare kerkesh apo specifikimesh keni hartuar? Nese jo, lutemi konfirmoni qe nuk duhet te ofertojme per kete sherbim “Hartimi i Strategjisë së Marketingut Dixhital të shoqërisë “Albpetrol” SH.A”. Nga specifikimet teknike dhe termat e references se procedures kerkohet qe OE vetem te prodhoje videot, fotot, dizajnet, dhe tja dorezoje Albpetrolit. Ky i fundit do te merret vete me publikimin e tyre, keshtu qe nuk e kemi te qarte kerkesen “Hartimi i Strategjisë së Marketingut Dixhital të shoqërisë “Albpetrol” SH.A”.*

## **PROBLEMATIKA 1.2**

*Ne listen e sherbimeve:*

*Nr Përshkrimi Sasia (Copë)*

*Realizim i videos të përgjithshme korporative për shoqërinë “Albpetrol” SH.A. 1*

*Realizim i videove informuese lidhur me 5 vendburimet e prodhimit të naftës që janë në administrim të “Albpetrol” SH.A. 5*

*Realizim i videove informuese dhe promovuese të Reparteve Prodhuese dhe Shërbimeve të “Albpetrol” SH.A. 5*

*Realizim i arkivit të përmbajtjes vizuale dhe multimediale për marketingun digital dhe rrjetet sociale për t'u përdorur në të gjithë harkun kohor të 1 (një) viti ku përfshihen: 1 30 video montazhe 30*

*b. 100 fotografi profesionale 100*

*c. 120 designe për postime 120*

*Shohim qe per zerin 4 “Realizim i arkivit të përmbajtjes vizuale dhe multimediale për marketingun digital dhe rrjetet sociale për t'u përdorur në të gjithë harkun kohor të 1 (një) viti ku përfshihen:” eshte vendosur sasia 1 cope, nderkohe qe ky ze eshte ndare ne pikat a, b dhe c. Pra zeri 4 ne vetvete eshte permbledhje e tre pikave a, b, c, ku secila prej tyre ka sasi te percaktuar 30, 100, 120 cope, por nderkohe ka edhe sasia 1 cope tek zeri 4, qe do te thote qe ne si ofertues duhet te vendosim cmim edhe tek zeri 4, edhe tek zerat a, b, c.*

*Kjo gje eshte e paqarte, mendojme se sasia “1 cope” te zeri “Realizim i arkivit të përmbajtjes vizuale dhe multimediale për marketingun digital dhe rrjetet sociale për t'u përdorur në të gjithë harkun kohor të 1 (një) viti ku përfshihen:” eshte vendosur gabimisht dhe duhet te hiqet, dhe ne si OE nuk duhet te ofertojme per zerin 4, por duhet te ofertojme per zerat a, b, c. Lutemi na sqaroni ne lidhje me kete pike: nese duhet te ofertojme per zerin 4 lutemi na sqaroni cfare sherbimesh te tjera, vec atyre te renditura ne pikat a, b, c, perfshin zeri 4.*

## **ARSYETIMI I KSHA:**

*1. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit dhe konsultimi me specialistët e fushës që kanë hartuar specifikimet teknike dhe termat e referencës, përsa i përket problematikës 1.1 të pikës 1 të ankesës së OE, që Hartimi i Strategjisë së Marketingut Dixhital nuk është përfshirë në tabelën e produkteve të procedurës dhe as nuk jepen sqarime apo specifikime për këtë pikë, KSHA argumenton se: Hartimi i Strategjisë së Marketingut Dixhital të shoqërisë “Albpetrol” SH.A ka*

si qëllim hartimin e një plani marketingu për shoqërinë “Albpetrol” SH.A në formën e një strukturë të përgjithshme që do të orientojë kompaninë në promovimin e mallrave apo shërbimeve të saj në tregun e saj të synuar, si dhe promovimin e aktivitetit të saj të përditshëm dhe të investimeve që do të ndikojnë në përmirësimin e kushteve të punës së punonjësve të saj, si edhe të jetesës së komunitetit përreth.

a. Strategjia e Marketingut Dixhital duhet që të kombinojë elemente të qartë marketingu, të cilët do të ndihmojnë shoqërinë “Albpetrol” SH.A që të përputhet në mënyrë efikase me burimet që ka dhe përpjekjet e saj për të arritur objektiva të veçanta.

b. Strategjia e Marketingut Dixhital duhet që të përcaktojë metodat që do të aplikohen/përdoren që marketingu i shoqërisë “Albpetrol” SH.A (referohu qëllimit në paragrafin më lart) të funksionojë dhe po kështu të projektohen hapat posaçërisht për tregun/publikun në varësi të qëllimit.

Përsa më lart, duke qënë se Strategjia e Marketingut Dixhital duhet që të hartohet nga ekspert teknik dhe të specializuar në këtë fushë, si dhe për rrjedhojë për hartimin e saj do të përdoren burime njerëzore e për pasojë do të duhet kohë pune, të cilat të dyja bashkë do të përkthehen në vlerë monetare,

KSHA vlerëson që ky pretendim i ankimuesit për pikën 1.1 qëndron. Njësia e prokurimit të reflektojë ndryshimet me hartimin e një shtojce në DST.

2. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit dhe konsultimi me specialistët e fushës që kanë hartuar specifikimet teknike dhe termat e referencës, përsa i përket problematikës 1.2 të pikës 1 të ankesës së OE, që zëri “Realizim i arkivit të përmbajtjes vizuale dhe multimediale për Albpetrol sh.a. NUIS J82916500U Selia Rr. “Fier-Patos”, Km. 7, Patos T +3553813662 F marketingun digital dhe rrjetet sociale për t’u përdorur..., në formularin e shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit është trajtuar si përmbledhës për nënzërat...”, KSHA argumenton se:

Në këtë rast është e qartë që do të ofertohet për nënzërat duke përcaktuar vlerë ofertimi në listën e çmimeve për secilin nga këta nënzëra. Totali (shumatorja) i këtyre 3 (tre) nënzërave do të jetë i përcaktuar me ofertë për zërin kryesor “Realizim i arkivit të përmbajtjes vizuale dhe multimediale për marketingun digital dhe rrjetet sociale për t’u përdorur në të gjithë harkun kohor të 1 (një) viti”.

Por për saktësimin e saj dhe për shmangien e çdo problematike apo keqinterpretimi që mund të lind nga ky përshkrim,

KSHA vlerëson që ky pretendim i ankimuesit për pikën 1.2 qëndron. Njësia e prokurimit të reflektojë ndryshimet me hartimin e një shtojce në DST.

2. Ankimuesi arsyeton si më poshtë

PIKA 2

Ne DST është përcaktuar afati i levrimit 30 dite. Ne shtojcat 6, 7, 8, përcaktohet: Afati për dorëzimin dhe përfundimin e këtij shërbimi duhet të bëhet për një periudhë kohore jo më shumë se 30 (tridhjetë ditë) nga lidhja e Kontratës.

PROBLEMATIKA 2.1

Sikurse vërehet nga specifikimet teknike të procedurave dhe nga lista e produkteve, shërbimet që kerkohen janë të shumta dhe të një natyre të tilla që kerkohen kohën e tyre për tu realizuar.

Kerkohet qe OE te realizojne filmime ne shume pika, filmimet do te jene me kamera dhe me dron: Sekuenca të filmuara me kamera në lartësi nëpërmjet dronit. Sekuenca të filmuara në nivelin e syrit apo të tokës. Të kenë skena nga objektet kryesore të shoqërisë “Albpetrol” SH.A.

Video 1 - Vendburimin Kuçovë,

Video 2 - Vendburimin Cakran në Mollaj,

Video 3 - Vendburimin Gorisht në Kocul

Video 4 - Vendburimin Amonicë,

Video 5 - Vendburimin Patos.

Video 1 - Qendra e Emergjencave të Naftës dhe Gazit (Q.E.M.N.G) Patos,

Video 2 - Qendra e Furnizimit Teknik (Q.F.T) Patos,

Video 3 - Qendra e Shërbimit Gjeologjik (Q.SH.GJ) Patos,

Video 4 - Qendra e Furnizimit dhe Shërbimit Elektrik (Q.F.SH.E) Patos,

Video 5 - Qendra Mekanike e Naftës (Q.M.N) Kuçovë.

Ne specifikimet teknike gjithashtu kerkohet:

Operatori Ekonomik duhet të krijojë konceptin, skenarin dhe storyboard-in e spotit televiziv. Përpara përgatitjes së videove, operatori ekonomik duhet të prezantojë një ide nëpërmjet një 'storyboard', i cili duhet të ketë në përmbajtje ideimin, krijimin dhe skenarin e spotit korporativ. Kerkohen vec videove kryesore edhe 30 video montazhe, 100 fotografi profesionale, 120 designe për postime, ku vetem ideimi dhe realizimi i 120 dizajneve kerkon minimalisht 30 dite. Ne keto kushte kerkojme qe afati i realizimit te sherbimeve te jete se paku 120 dite, ne menyre qe ti lihet OE koha per te punuar. Sjellim ne vemendje qe realizimi i filmimeve eshte ne varesi te kushteve atmosferike, te cilat tani ne periudhen e pranveres jane te paqendrueshme, prandaj vetem per te filluar punen me filmimet mund te linde nevoja te pritet me dite te tera permiresimi i kushteve te motit. Pastaj realizimi i filmimeve ne se paku 10 pika filmimesh kerkon minimalisht dy jave pune. Me tej perpunimi, projektimi, ideimi dhe realizimi i 11 videove (me efekte zanore, grafike, narracion, perkthim, etj) gjithashtu kerkon kohen prej minimalisht dy muaj. Dhe se fundmi 120 punime dizajn kerkojne se paku 45 dite. Ne proces-verbalin e argumentimit te kriterave nuk gjejme ndonje sqarim pse eshte vendosur nje afat kaq i shkurter levrimi, nderkohe qe materialet qe do te prodhohen do te perdoren per publikime gjate 1 viti, pra ne nje periudhe mjaftueshem te gjate, nuk jane urgjente.

**PROBLEMATIKA 2.2** Ne specifikimet teknike per videon 1 kerkohet: Operatori Ekonomik duhet të krijojë konceptin, skenarin dhe storyboard-in e spotit televiziv. Përpara përgatitjes së videove, operatori ekonomik duhet të prezantojë një ide nëpërmjet një "storyboard", i cili duhet të ketë në përmbajtje ideimin, krijimin dhe skenarin e spotit korporativ. Lutemi koha qe merr AK per te konfirmuar konceptin, skenarin dhe storyboard-in e spotit televiziv te mos perfshihet ne afatin e levrimit qe ka ne dispozicion OE, pasi AK mund te kete nevoje ta studioje propozimin dhe ky proces mund te kerkoje dite te tera. Natyrisht AK mund te marre kohen qe i nevojitet, por ky afat/keto dite, te mos perfshihen ne afatin e levrimit te OE.

**PROBLEMATIKA 2.3**

Ne shojcen 6 FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE dhe ne shtojcen 8 FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS, per zerat 1, 2, 3, kerkohet: Operatori Ekonomik duhet të sigurojë

të gjithë infrastrukturën e nevojshme për realizimin e videove: transportin, stafin dhe lejet e xhirimit në secilat prej pikave të shoqërisë “Albpetrol” SH.A të parapërcaktuara për xhirime. Lutemi na sqaroni cfare do te thote qe OE duhet te siguroje leje nga Albpetrol per te realizuar filmime ne pikat e Albpetrol, nderkohe qe mes OE dhe Albpetrolit do te jete nje kontrate te firmosur mes paleve dhe vete Albpetrol ka kerkuar qe OE te beje keto xhirime dhe ka percaktuar pikat e xhirimit. Nuk e kuptojme per cfare leje e keni fjalen. Sipas udhezimeve te APP nje AK nuk duhet ti kerkoje OE dokumenta te cilat i zoteron vete AK, sic eshte kjo leje.

ARSYETIMI I KSHA: 1. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit dhe konsultimi me specialistët e fushës që kanë hartuar specifikimet teknike dhe termat e referencës, përsa i përket problematikës 2.1 dhe 2.2 të pikës 2 të ankesës së OE, KSHA argumenton se:

Shoqëria “Albpetrol” SH.A është një shoqëri tregtare, e cila veprimtarinë e saj e kryen në bazë të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, ku në zbatim të tij miraton Programin e Zhvillimit Ekonomik për vitin ushtrimor aktual pranë Asamblesë së Përgjithshme (Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në cilësinë e pronarit të aksioneve të shoqërisë “Albpetrol” SH.A). Ky Program është dokumenti bazë ekonomik dhe administrativ që shoqëria “Albpetrol” SH.A kryen aktivitetin e saj, në rastin konkret për vitin 2025, Program ky që efektet e tij i ka deri në datën 31.12.2025.

Mbështetur në shpjegimet më lart, shërbimi i kërkuar është i nevojshëm që të kryhet sa më shpejt dhe është llogaritur që të realizohet brenda një afati kohor prej 30 (tridhjetë) ditësh për shkak të arritjes së objektivave dhe nevojës së shoqërisë “Albpetrol” SH.A për të promovuar shërbimet dhe investimet e programuara posaçërisht për vitin 2025. Theksojmë këtu se, realizimi i zërave të kërkuar nga ana e AK janë të ndërthurur me njëri tjetrin dhe për realizimin e tyre mjafton dalja në terren maksimumi vetëm 1 (një) ditë për secilën Qëndër (pikë që do të bëhen foto dhe/ose video), respektivisht 3-6 orë punë/ditë sipas proceseve të punës dhe shtrirjes në terren që kanë. Shoqëria “Albpetrol” SH.A ka nën admintrim 10 (dhjetë) Qendra dhe vendosja e afatit të realizimit prej 30 (tridhjetë) ditësh është gjykuar i mjaftueshëm për të zbatuar grafikun si më poshtë:

| Pik<br>a 1 | Emërtesa                                            | Vendondod<br>hja | Grafik<br>u<br>daljes<br>në<br>terren | Shqyrtimi<br>dhe<br>përzgjedhja e<br>fotove dhe<br>videove<br>(OE+Albpetr<br>ol) | Montaz<br>hi |
|------------|-----------------------------------------------------|------------------|---------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------|--------------|
| 1          | Qendra e Prodhimit të Naftës Fier                   | Patos            | Dita 1                                | 2 ditë                                                                           | 20 ditë      |
| 2          | Qendra e Prodhimit të Naftës Kucovë                 | Kuçovë           | Dita 2                                |                                                                                  |              |
| 3          | Qendra e Uzinës Mekanike Kucovë                     |                  |                                       |                                                                                  |              |
| 4          | Qendra e Prodhimit të Naftës Gorisht                | Vlorë            | Dita 3                                |                                                                                  |              |
| 5          | Qendra e Administrimit dhe Kontrollit të Pronës     | Patos            | Dita 4                                |                                                                                  |              |
| 6          | Qendra e Emergjencave, Mjedisit të Naftës dhe Gazit | Patos            | Dita 5                                |                                                                                  |              |
| 7          | Qendra e Administrimit, Shitjes të Naftës Gazit     | Patos            |                                       |                                                                                  |              |
| 8          | Qendra Furnizimit dhe Shërbimeve Elektrike          | Patos            | Dita 6                                |                                                                                  |              |
| 9          | Qendra e Shërbimeve Gjeofizike                      | Patos            | Dita 7                                |                                                                                  |              |
| 10         | Qendra e Furnizimit dhe Transportit                 | Patos            |                                       |                                                                                  |              |
|            | Rezervë për shkak të ngjarjeve të paparashikueshme  |                  | Dita 8                                |                                                                                  |              |

Nga studimi i tregut në këtë fushë dhe eksperiencat e mëparshme, AK ka përcaktuar afatin kohor duke u bazuar në nevojat e tij dhe kohën e nevojshme që do t'i duhet çdo OE të interesuar për realizimin me sukses të kontratës. Video montazhet e kërkuara për t'u realizuar nuk janë me metrazh të gjatë por as më të shkurtra se 15 sekonda, si dhe fotot dhe videot që do të kryhen për çdo pikë do të nderthuren me njëra tjetrën, proces ky që shkurton kohën e realizimit dhe përdorimin e saj me efektivitet.

Në gjykimin e KSHA-së, afati për dorëzimin dhe përfundimin e këtij shërbimi duhet të bëhet për një periudhë kohore jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nga lidhja e Kontratës, afat ky që është mëse i mjaftueshëm për çdo OE të interesuar, bazuar dhe në qëllimin kryesor të AK-së për realizimin e kësaj procedure që është: “Përcjellja e mesazhit se shoqëria “Albpetrol” SH.A ka përmirësuar qëndrimet dhe proceset ndaj mjedisit, duke minimizuar ndotjen dhe duke investuar në teknologji të reja për të mbrojtur ambientin”, posaçërisht për vitin 2025. Përsa më lart, KSHA vlerëson që ky pretendim i ankimesit për pikën 2.1 dhe 2.2 nuk qëndron.

2. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit dhe konsultimi me specialistët e fushës që kanë hartuar specifikimet teknike dhe termat e referencës, përsa i përket problematikës 2.3 të pikës 2 të ankesës së OE, KSHA argumenton se: Nisur nga objekti i punës së shoqërisë “Albpetrol” SH.A që është prodhimi dhe nxjerrja e naftës, sqarojmë se për shkak të rrezikshmërisë, identifikimit të zonave dhe mjeteve të renda të përdorura në këtë industri, lind nevoja që punonjësit e ngarkuar nga OE të trajnohen për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë në zbatim të përcaktimeve të ligjit Nr.10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”. Hyrja

e tyre në këto ambjente pune duhet të jetë e orientuar dhe të jenë të shoqëruar nga punonjës të shoqërisë “Albpetrol” SH.A, me qëllim shmangien e çdo problematike të mundshme që mund të rrezikojë shëndetin e tyre.

Pra, OE i kontraktuar nuk mund të veprojë në territoret naftënxjerrëse krejt i pavaruar apo i pashoqëruar nga staf i shoqërisë “Albpetrol” SH.A, duke bërë të qartë këtu që leja do të jetë pjesë e komunikimit që kontraktuesi do të ketë me të kontraktuarin, verbale dhe jo shkresore, pasi ky i fundit lajmëron për paraqitjen pranë ambjenteve të punës së AK-së. Me realizimin e këtij prokurimi publik, çdo paqartësi e OE fitues do të qartësohet nëpërmjet përcaktimeve të kontratës që do të lidhet midis palëve.

Përsa më lart, KSHA vlerëson që ky pretendim i ankimuesit për pikën 2.3 nuk qëndron.

3. Ankimuesi arsyeton si më poshtë

#### PIKA 3

Ne kriteret e vecanta per kualifikim eshte kerkuar: Per te vertetuar qe operatori ekonomik ka kapacitete njerezore profesionale te mjaftueshme per realizimin ne kohe e cilesi te kontrates, duhet te kete staf minimalisht 10 (dhjetë) punonjes. Për këtë të paraqitet:

- Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve minimalisht për tre muajt e fundit.

Shenim: Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojces nr. 10. Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

#### PROBLEMATIKA 3.1

Numri i punonjesve te kerkuar eshte shume i larte dhe ne proces verbalin e argumentimit te kriterëve nuk gjejmë asnjë sqarim se çfarë funksioni do të kenë këta 10 punonjes ne kete procedure, çfarë pune do të bëjnë këta 10 punonjes, nuk gjejmë asnjë sqarim apo argumentim teknik perse po kerkohen kaq shume punonjes te cilet domosdoshmerisht duhet te figurojne ne listepagese. AK ka detyrimin te argumentojë ligjerisht dhe teknikisht, çfarë shërbimi/pune do të kryejë secili nga 10 punonjesit e kerkuar, bazuar ne zerat e procedures. Ky kriter pengon biznesin e vogel dhe te mesem te ofertoje ne menyre te paargumentuar, duke kufizuar konkurrencen. Lutemi numri i punonjesve te cilet figurojne ne listepagese te jete jo me shume se 3, ne menyre qe kriteri te jete sa me gjithëperfshires.

#### PROBLEMATIKA 3.2

Eshte kerkuar te paraqitet “Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve minimalisht për tre muajt e fundit”. Synimi i kriterit eshte qe AK te njihet me gjendjen dhe kapacitetet aktuale te OE, jo me gjendjen qe kishte para 3 muajve. Ne 3 muaj situata e OE mund te ndryshoje, mund te perkeqesohet apo permiresohet, por synimi eshte te njihen kapacitetet aktuale te kompanive, dhe jo te vleresohen per kapacitet qe kishin para 3 muajve. Lutemi te kerkohet Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore per muajin e fundit.

PROBLEMATIKA 3.3 Lutem specifikoni cilin konsideroni muaj te fundit: muajin e fundit te maturuar para shpalljes se procedures apo muajin e fundit te maturuar para dates se zhvillimit te procedures?

*ARSYETIMI I KSHA: 1. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit dhe konsultimi me specialistët e fushës që kanë hartuar specifikimet teknike dhe termat e referencës, përsa i përket problematikës 3.1 të pikës 3 të ankesës së OE, KSHA argumenton se:*

*Kërkesat për punonjës janë kërkuar në bazë të pikës 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku nëpërmjet këtij kriteri provohet se operatorët ekonomikë provojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. Shoqëria “Albpetrol” SH.A duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për zbatimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.*

*Për të garantuar realizimin me sukses të këtij shërbimi me cilësi dhe në kohë, duke marrë në konsideratë edhe shtrirjen e punës në terren është e pamundur që të kryhet ky projekt me të paktën 3 (tre) punonjës të kualifikuar në këtë fushë. Për realizimin e këtij projekti duhet që domosdoshmërisht të jetë:*

*- 1 (një) punonjës “Regjisor”, i cili do të jetë drejtuesi artistik i punës që do të kryhet në terren dhe funksioni i tij është që të sigurojë cilësi dhe tërësi të realizimit të vizionit të projektit. Regjisori do të mbikëqyr dhe do të bashkërendojë punën për montimin e prodhimit (foto dhe video).*

*- 1 (një) punonjës Specialist Marketingu, i cili do të hartojë dokumentin e Strategjisë së Marketingut Dixhital për shoqërinë “Albpetrol” SH.A dhe pasi ka studiuar tregon për të arritur qëllimin e shoqërisë “Albpetrol” SH.A do të përgatisë planin për zhvillimin dhe zbatimin e kësaj Strategjie, përmbajtjen e videove për mediat sociale për të rritur ndërveprimin, si dhe projektimin e metodave dhe hapat që do të ndiqen për publikimin e materialeve, pjesë përberëse të këtij shërbimi.*

*- 2 (dy) punonjës Designer në Multimedia, të cilët duhet që të jenë të profesionalizuar në fushën e dizajnit grafik dhe që janë të aftë profesionalisht për ofrimin e shërbimeve të ndryshme që janë të rëndësishme për këtë fushë, duke përdorur teknologjinë dhe aplikacionet e kohës së fundit, të cilat u përshtaten lehtë kërkesave të tregut dhe target grupin që ka shoqëria “Albpetrol” SH.A. Sqarojmë këtu se, janë kërkuar 2 (dy) punonjës sepse bëhet fjalë për përpunimin e një arkivi me sasi të konsiderueshme fotografish dhe videosh, si dhe puna për realizimin në kohë të këtij shërbimi nuk mund të kryhet nga 1 (një) person.*

*Në vijim të këtyre shpjegimeve, AK ka kërkuar që punonjësit të jenë të përfshirë në listëpagesat e 3 (tre) muajve të fundit për të marrë garancinë që OE që do të shpallet fitues për lidhjen e kontratës ka eksperiencën e duhur teknike dhe organizative, si dhe punonjësit e saj janë të konsoliduar në këtë fushë dhe në gjendje të bashkëpunojnë lehtësisht me njëri tjetrin për realizimin e shërbimit të kërkuar në kohë dhe me cilësi sipas standarteve të kërkuara.*

*Përsa më lart, KSHA vlerëson që ky pretendim i ankimesit për pikën 3.1 nuk qëndron.*

*2. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit dhe konsultimi me specialistët e fushës që kanë hartuar specifikimet teknike dhe termat e referencës, përsa i përket problematikës 3.2 dhe 3.3 të pikës 3 të ankesës së OE, KSHA argumenton se:*

*Kërkesa për “Vërtetimin e lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve minimalisht për tre muajt e fundit” është kërkuar për të marrë garancinë që OE që do të shpallet fitues për lidhjen e kontratës ka eksperiencën e duhur teknike dhe organizative, si dhe punonjësit e saj janë të konsoliduar në këtë fushë dhe në gjendje të bashkëpunojnë lehtësisht me njëri tjetrin për realizimin e shërbimit të kërkuar në kohë dhe me cilësi sipas standarteve të kërkuara. Pra, periudha kohore prej 3 muajsh është mëse e mjaftueshme që kompania të konsolidohet dhe të formohet nga ana organizative (proces ky që nuk mund të arrihet me 1 (një) muaj). Po kështu sqarojmë se, me togfjalëshin “muaj i fundit” kuptohet muaji i fundit i maturuar para shpalljes së procedurës në fjalë.*

*Përsa më lart, KSHA vlerëson që ky pretendim i ankimuesit për pikën 3.2 dhe 3.3 nuk qëndron.*

*4. Ankimuesi arsyeton si më poshtë: PIKA 4 Ne kriteret e vecanta per kualifikim eshte kerkuar: Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij punonjës te kualifikuar si me poshte: - 1 (një) punonjës Regjizor - 1 (një) punonjës Specialist Marketingu - 2 (dy) punonjës Designer në Multimedia Për secilin punonjës të paraqiten: - Diploma e arsimit të lartë - Kontratë punësimi - Listëpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit, në të cilat punonjësit e sipërcituar duhet të figurojnë. Shenim: Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojces nr. 10. Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.*

#### **PROBLEMATIKA 4.1**

*Punonjesit e kualifikuar jane kerkuar qe te jene domosdoshmerisht te punesuar prane OE dhe te figurojne ne listepagesa, duke perjashtuar mundesine qe keta specialiste te kontraktohen me kontrata sherbimi/angazhimi, nje menyre punesimi e parashikuar nga Kodi i Punes.*

*Ne proces verbalin e argumentimit te kriterëve nuk gjejme ndonje sqarim se ne c'menyre do te demtohej procedura nese keta specialiste kontraktohen me kontrate sherbimi nga OE qe ne momentin e ofertimit ne tender. Ne kete forme qe eshte tani kriteri eshte kufizues dhe behet pengese per ofertim per OE, sidomos per biznesin e vogel apo te mesem, qe nuk mund te mbaje te punesuar per gjithe kohen specialiste te tille si regjisore apo dy dizajner, te cilet jane edhe te kushtueshem. Lutemi te lejohet ofertimi me specialiste te kontraktuar nga ana e OE ne menyre qe kriteri te mos behet pengese per ofertim dhe te jete sa me gjithëperfshires.*

#### **PROBLEMATIKA 4.2**

*Eshte kerkuar te paraqiten listepagesat e tre muajve te fundit. Synimi i kriterit eshte qe AK te njihet me gjendjen dhe kapacitetet aktuale te OE, jo me gjendjen qe kishte para 3 muajve. Ne 3 muaj situata e OE mund te ndryshoje, mund te perkeqesohet apo permiresohet, por synimi eshte te njihen kapacitetet aktuale te kompanive, dhe jo te vleresohen per kapacitet qe kishin para 3 muajve. Lutemi te kerkohet listepagesa per muajin e fundit.*

#### **PROBLEMATIKA 4.3**

*Lutem specifikoni cilin konsideroni muaj te fundit: muajin e fundit te maturuar para shpalljes se procedures apo muajin e fundit te maturuar para dates se zhvillimit te procedures?*

**PROBLEMATIKA 4.4** *Per secilin nga punonjesit e kualifikuar eshte kerkuar te paraqitet diploma e arsimit te larte duke perjashtuar certifikimet apo deshmite e leshuara nga institucione te akredituara bazuar ne ligjin per arsimin Nr.15 te Vitit 2017 “Për Arsmin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”. Ne nje suate krejtesisht te njejte, Komisioni i Prokurimit Publik ne vendimin Nr. 223/2025 date 11.02.2025, arsyetoi: Komisioni gjykon, se ky kriter i vendosur nga autoriteti kontraktor është kufizues, pasi mënyra sesi është formuluar kriteri ka ndaluar certifikatat apo dëshmit e tjera të leshuara nga Institucione të Akredituara, sikurse parashikon edhe ligjin Nr.15 të Vitit 2017 “Për Arsmin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”, në cilën përcaktohet qartësisht se certifikatat/dëshmitë/diplomat janë dokumente zyrtare të llojeve të ndryshme, të cilat vërtetojnë arritjet/njohurit e një specialisti për një fushë të caktuar. Pasi në nenin 16 pika 3 të ligjit Nr.15 të Vitit 2017 “Për Arsmin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”, citohet se kualifikimet e plota ose të pjesshme profesionale mund të përftohen nëpërmjet këtyre formave: a) ndjekjes së arsimit profesional me bazë shkollën; b) ndjekjes së kurseve profesionale, ku përfshihen edhe praktikat profesionale në ndërmarrje apo forma të tjera të mësimnxënies praktike; c) regjistrimit si nxënës, duke u punësuar në një ndërmarrje (forma e dyfishtë); ç) njohjes të të nxënës të mëparshëm informal dhe joformal; d) njohjes të të nxënës të përfutur jashtë vendit; dh) formave të tjera të përcaktuara me ligj. Komisioni gjykon, se kërkesa e autoritetit kontraktor për një dizajner që të ketë mbaruar shkollën e lartë dhe duke përjashtuar si formim arsimin profesional është një kërkesë e ekzagjeruar, dhe nuk është në proporcion me objektin dhe qëllimin e kontratës. Komisioni gjykon, se për autoritetin kontraktor e rëndësishme është realizimi i shërbimit. Ky shërbim mund të realizohet nga një punonjës i specializuar në profesionin dizajner, me arsim profesional ashtu sikurse një specialist që ka mbaruar shkollën e lartë. Autoriteti kontraktor të rishikojë kriterin e veçantë të kualifikimit në mënyrë që të hapet konkurrenca ndërmjet operatorëve ekonomikë. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në përcaktimin/apo vendosjen e kriterëve për kualifikim ligjvënës i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe (ii) jodiskriminuese, duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Duke analizuar kriterin kualifikues, Komisioni gjykon, se Autoriteti kontraktor me qëllim që të lehtësojë operatorët ekonomikë në përgatitjen e ofertave si edhe të hapë konkurrencën për operatorët ekonomikë të biznesit të mesëm dhe të vogël, duhet të modifikojë kriterin e kërkuar, në mënyrë që tu japi mundësi edhe atyre operatorëve ekonomik që disponojnë një specialist me titullin dizajner me formim profesional sipas përcaktimeve në ligjin nr.15 të vitit 2017 “Për Arsmin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”. Në këtë kuadër, KPP gjykon, se për sa kohë kërkesa e mësipërme nuk i shërben qëllimit të autoritetit kontraktor dhe shkon përtej asaj që është e nevojshme për arritjen e qëllimit, autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e kriterit në mënyrë që të hapet konkurimi. Prandaj kërkojme që te pranohen si deshmi edhe certifikimet apo deshmit e leshuara nga institucione te akredituara per keto profesione.*

#### PROBLEMATIKA 4.5

Per profesionet e kerkuara: regjizor, specialist marketingu, Designer në Multimedia, diplomat/deshmite/certifikimet e leshuara mund te mos kene sakesisht kete emertim. Bazuar ne Ligjin per Arsimin, si edhe ne Ligjin e Prokurimit Publik, neni 77: Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. kërkojme qe te pranohen diplomat/deshmite/certifikimet qe provojne se punonjesit jane specialiste te fushave te kerkuara: regjisure, marketing, dizajn, pavaresisht se si eshte shkruar sakesisht ne diplomat/deshmite/certifikimet. Qellimi i kriterit eshte qe AK te njihet me kapacitet e OE dhe te bindet qe OE ka ne dispozicion te realizimit te procedures profesioniste te kualifikuar ne fushat regjisure, marketing, dizajn, pa kushtezuar qe ne dokumentin provues te jete shenuar sakesisht fjale per fjale terminologjia e kerkuara nga AK specialist marketingu apo Designer në Multimedia. Specialiste marketingu, bazuar ne VKM 514 datë 20.9.2017 Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (lqp) të rishikuar, mund te jene te gjithë te arsimuarit ne deget e ekonomise, marketingut, shitjeve, etj, po ashtu Designer në Multimedia, bazuar ne VKM 514 datë 20.9.2017 Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (lqp) të rishikuar, mund te jene te gjithë te arsimuarit ne fusha si dizajn, media, art, etj Lutemi te pranohen dokumenta provuese per arsimim ne fusha si regjisure, marketing, dizajn, sipas percaktimeve ne VKM 514 datë 20.9.2017 Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (lqp) të rishikuar.

#### PROBLEMATIKA 4.6

Lidhur me punonjesin “Specialist Marketingu”, per sa kohe qe zeri “Hartimi i Strategjisë së Marketingut Dixhital të shoqërisë “Albpetrol” SH.A.” nuk eshte i perfshire ne listen e produkteve te procedures, nuk ka arsye te kerkohet Specialist Marketingu, prandaj kerkojme qe kjo kerkese te hiqet pasi nuk eshte e argumentuar dhe nuk ka lidhje me proceduren.

#### ARSYETIMI I KSHA:

1. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit dhe konsultimi me specialistët e fushës që kanë hartuar specifikimet teknike dhe termat e referencës, përsa i përket problematikës 4.1 të pikës 4 të ankesës së OE, KSHA argumenton se:

Kërkesa për punonjës të punësuar pranë OE, legjitimohet me nevojat që ka AK për kryerjen në kohë të shërbimit dhe kapacitetin teknik që ky OE duhet të plotësojë, me qëllim realizimin me sukses të kontratës, duke marrë parasysh objektin e vecantë të saj. Theksojmë se, kërkesa që punonjësit të jenë në listëpagesë është kërkuar për të marrë garancinë që OE që do të shpallet fitues për lidhjen e kontratës ka eksperiencën e duhur teknike dhe organizative, si dhe punonjësit e saj janë të konsoliduar në këtë fushë dhe në gjendje të bashkëpunojnë lehtësisht me njëri tjetrin për realizimin e shërbimit të kërkuar në kohë dhe me cilësi sipas standarteve të kërkuara. Pra, një kompani që ka punonjësit e saj ka më tepër siguri që ka kapacitetin e nevojshëm për të kryer këtë shërbim, sesa t’i marrë me kontraktim nga palë të treta. Përsa më lart, KSHA vlerëson që ky pretendim i ankimuesit për pikën 4.1 nuk qëndron.

2. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit dhe konsultimi me specialistët e fushës që kanë hartuar specifikimet teknike dhe termat e referencës, përsa i përket problematikës 4.2 të pikës 4 të ankesës së OE, KSHA argumenton se:

*Për këtë pikë, duke qënë se pretendimi është i përsëritur, sqarojmë se vlen i njëjti arsyetim sa më sipër.*

*Përsa më lart, KSHA vlerëson që ky pretendim i ankimuesit për pikën 4.2 nuk qëndron.*

*3. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit dhe konsultimi me specialistët e fushës që kanë hartuar specifikimet teknike dhe termat e referencës, përsa i përket problematikës 4.3 të pikës 4 të ankesës së OE, KSHA argumenton se: Sqarojmë se, me togfjalëshin “muaj i fundit” kuptohet muaji i fundit i maturuar para shpalljes së procedurës në fjalë.*

*Përsa më lart, KSHA vlerëson që ky pretendim i ankimuesit për pikën 4.3 nuk qëndron.*

*4. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit dhe konsultimi me specialistët e fushës që kanë hartuar specifikimet teknike dhe termat e referencës, përsa i përket problematikës 4.4 të pikës 4 të ankesës së OE, KSHA argumenton se:*

*Kërkesa për punonjës të punësuar pranë OE, legjitimohet me nevojat që ka AK për kryerjen në kohë të shërbimit dhe kapacitetin teknik që ky OE duhet të plotësojë, me qëllim realizimin me sukses të kontratës, duke marrë parasysh objektin e vecantë të saj. Në këtë kontekst sqarojmë se, nuk mund të jenë të barazvlefshëm si cikël studimesh Diploma universitare me Certifikatën e trajnimit. Një person që është diplomuar dhe ka kryer cikël të plotë studimi ka dije më të thelluara dhe profesionale sesa një person që ka kryer një trajnim afatshkurtër. Në rast të kundërt nuk do të ekzistonte diploma por do të mjaftonte vetëm certifikata.*

*Përsa më lart, KSHA vlerëson që ky pretendim i ankimuesit për pikën 4.4 nuk qëndron.*

*5. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit dhe konsultimi me specialistët e fushës që kanë hartuar specifikimet teknike dhe termat e referencës, përsa i përket problematikës 4.5 të pikës 4 të ankesës së OE, KSHA argumenton se: Për të garantuar realizimin me sukses të këtij shërbimi me cilësi dhe në kohë, duke marrë në konsideratë edhe shtrirjen e punës në terren është e nevojshme dhe e domosdoshme që të paktën 1 (një) punonjës të jetë “Specialist Marketingu” për arsyet siç i kemi parashtruat, të cilat janë më poshtë:*

*- 1 (një) punonjës Specialist Marketingu, i cili do të hartojë dokumentin e Strategjisë së Marketingut Dixhital për shoqërinë “Albpetrol” SH.A dhe pasi ka studiuar tregon për të arritur qëllimin e shoqërisë “Albpetrol” SH.A do të përgatisë planin për zhvillimin dhe zbatimin e kësaj Strategjie, përmbajtjen e videove për mediat sociale për të rritur ndërveprimin, si dhe projektimin e metodave dhe hapat që do të ndiqen për publikimin e materialeve, pjesë përberëse të këtij shërbimi.*

*Përsa më lart, KSHA vlerëson që ky pretendim i ankimuesit për pikën 4.5 nuk qëndron.*

*6. Ankimuesi arsyeton si më poshtë*

*PIKA 5*

*Ne specifikimet teknike per “Realizim i 1 (një) VIDEO të pergjithshme korporative për shoqërinë “Albpetrol” SH.A. Specifikimet teknike kërkohen si më poshtë” kerkohet: Spoti duhet të jetë në formatin MPEG 2 me CBR 35 dhe H 264 me CBR 35, me rezolucione 16 \* 9 (1920 x 1080 px)*  
*PROBLEMATIKA 5.1*

*Ne formularin e specifikimeve teknike, pika “Realizim i 1 (një) VIDEO të pergjithshme korporative për shoqërinë “Albpetrol” SH.A.” autoriteti kontraktor citon: f. Spoti duhet të jetë në formatin MPEG 2 me CBR 35 dhe H.264 me CBR 35 Ne lidhje me kete pike, MPEG-2 eshte kodek shume I vjeter. I lutemi AK-se te mbaje te vemendje qe version me I ri I diteve te sotme ka shkuar ne MPEG-5. Nderkohe versioni MPEG-4 ñ eshte me I perdorshmi aktualisht për internet, mobile, dhe streaming. Ju lutem AK te kerkoje formatin e videos MPEG-4 dhe te heqe kerkesen per MPEG-2. CBR 35 (Constant Bit Rate 35 Mbps) tregon se bitrati i videos do të jetë konstant në 35 megabit për sekondë. Ky është një bitrat mjaft i lartë, i përshtatshëm për transmetime televizive ose arkivim, por mund te shkaktoje probleme ne transmetim për rrjete sociale, sikurse dhe flitet ne kete procedure. I lutemi AK te ule bitrate pasi videot nuk do jene pjese e trasnmetimeve televizive dhe per kete arsye nuk ka perse te rrise kostot fiktivisht. Per me teper, shumica e platformave sociale nuk mbështesin CBR 35 Mbps: YouTube rekomandon H.264 me bitrat 8-12 Mbps për 1080p dhe 20 Mbps për 4K, Facebook dhe Instagram rekomandojnë bitratin 4-6 Mbps për 1080p, Google ads 8-12 Mbps për 1080p, TikTok dhe Tëitter preferojnë bitrat më të ulët, shpesh midis 3-5 Mbps*

#### **ARSYETIMI I KSHA:**

*1. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit dhe konsultimi me specialistët e fushës që kanë hartuar specifikimet teknike dhe termat e referencës, përsa i përket problematikës 5.1 të pikës 5 të ankesës së OE, KSHA argumenton se: Sic konstatohet në specifikimet teknike të përcaktuara nga AK, specifikimet teknike për videon korporative janë më të avancuara se videot e tjera dhe kjo për shkak se video korporative është projektuar që të përdoret në faqen online zyrtare te shoqërisë “Albpetrol” SH.A, për prezantime të ndryshme në eventet kombëtare dhe ndërkombëtare që merr pjesë shoqëria “Albpetrol” SH.A, si dhe pa u kufizuar, në rast se do të jetë e nevojshme do të përdoret edhe për transmetime televizive. Pra, kjo është një video e përgjithshme prezantuese e kompanisë që është kërkuar me qëllimin kryesor për të qënë pjesë e portofolit prezantues dhe protokollar të shoqërisë “Albpetrol” SH.A.*

*Përsa më lart, KSHA vlerëson që ky pretendim i ankimuesit për pikën 5.1 nuk qëndron.*

#### **PËR KËTO ARSYE:**

*Bazuar në nenin 114 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 102 të vendimit nr. 285, të Këshillit të Ministrave, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, KSHA*

#### **VENDOSI:**

- 1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga OE “OPTIMA COMMUNICATION” shpk.*
- 2. Ky vendim i komunikohet Titullarit të AK.*
- 3. Kopje e këtij vendimi i njoftohet OE ankimues dhe Komisionit të Prokurimit Publik.*

*II.5. Të njëjtin informacion për trajtimin e ankesës autoriteti kontraktor e ka paraqitur në KPP edhe përmes shërbimt postar përmes shkresës me nr. 1558/3 datë 02.04.2025 e cila u protokollua me tonën me nr. 803/2 prot., datë 07.04.2025.*

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor,

#### Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit për modifikimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Me datë 02.04.2025 autoriteti kontraktor ka ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike vendimin e KSHA për shqyrtimin e ankesës me nr. 1558/2 prot., datë 01.04.2025 i cili u protokollua me tonën me nr. 803/1 prot., datë 02.04.2025 ku ka pranuar pjesërisht atë, si më poshtë vijon:

*“[...] PIKA 1*

*Në shtojcën 6 FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE dhe në shtojcën 8 FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS, përshkruhet: Përshkrimi sasior i shërbimeve që kërkohen: Realizim i 1 (një) video të përgjithshme korporative për shoqërinë “Albpetrol” SH.A.*

*Realizim i 5 (pesë) videove informuese lidhur me 5 vendburimet e prodhimit të naftës që janë në administrim të “Albpetrol” SH.A.*

*Realizim i 5 (pesë) videove informuese dhe promovuese të Reparteve Prodhuese dhe Shërbimeve të “Albpetrol” SH.A.*

*Realizim i arkivit të përmbajtjes vizuale dhe multimediale për marketingun digital dhe rrjetet sociale për t'u përdorur në të gjithë harkun kohor të 1 (një) viti ku përfshihen:*

*➤ 30 video montazhe*

*➤ 100 fotografi profesionale*

*➤ 120 designe për postime*

*Kjo përmbajtje do të përfshijë: Përdorimi i Stories dhe Highlights për të krijuar kategori të veçanta, si Mjedis, Teknologjia e Re, Punonjësit Tanë dhe “Dita në jetën e punonjësve tanë”. Hartimi i Strategjisë së Marketingut Dixhital të shoqërisë “Albpetrol” SH.A.*

*Po në këto dy shtojca, si edhe në shtojcën 7 FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT, paraqitet lista e produkteve:*

*Nr Përshkrimi Sasia (Copë)*

*Realizim i videos të përgjithshme korporative për shoqërinë “Albpetrol” SH.A. 1 Realizim i videove informuese lidhur me 5 vendburimet e prodhimit të naftës që janë në administrim të “Albpetrol” SH.A. 5*

*Realizim i videove informuese dhe promovuese të Reparteve Prodhuese dhe Shërbimeve të “Albpetrol” SH.A. 5*

Realizim i arkivit të përmbajtjes vizuale dhe multimediale për marketingun digital dhe rrjetet sociale për t'u përdorur në të gjithë harkun kohor të 1 (një) viti ku përfshihen:

1 30 video montazhe 30

100 fotografi profesionale 100

120 designe për postime 120

#### PROBLEMATIKA 1.1

Brenda ketyre shtojcave ka mosperputhje. Në pikën A: “Përshkrimi sasior i shërbimeve që kërkohen” renditen 5 (pesë) shërbime. Në tabelat me zerat e procedures renditen 4 (kater) shërbime. Shërbimi i peste “Hartimi i Strategjisë së Marketingut Dixhital të shoqërisë “Albpetrol” SH.A” nuk është i përfshirë në tabelën e produkteve të procedures, dhe as nuk jepen sqarime apo specifikime për këtë pikë. Lutemi na sqaroni nëse kërkohet që të ofertojmë për “Hartimi i Strategjisë së Marketingut Dixhital të shoqërisë “Albpetrol” SH.A” apo jo. Nëse po lutemi shtojeni këtë në listën e produkteve të procedures, si edhe jepni specifikimet përkatëse sikurse i keni dhënë për të gjitha zerrat e tjera. Lutem referojuni llogaritjes që keni bërë për fondin limit, si e keni llogaritur fondin për pikën 5, çfarë kërkesash apo specifikimesh keni hartuar? Nëse jo, lutemi konfirmoni që nuk duhet të ofertojmë për këtë shërbim “Hartimi i Strategjisë së Marketingut Dixhital të shoqërisë “Albpetrol” SH.A”. Nga specifikimet teknike dhe termat e references së procedures kërkohet që OE vetëm të prodhojë videot, fotot, dizajnet, dhe tëja dorëzojë Albpetrolit. Ky i fundit do të merret vetë me publikimin e tyre, kështu që nuk e kemi të qartë kërkesën “Hartimi i Strategjisë së Marketingut Dixhital të shoqërisë “Albpetrol” SH.A”.

#### PROBLEMATIKA 1.2

Në listën e shërbimeve:

Nr Përshkrimi Sasia (Copë)

Realizim i videos të përgjithshme korporative për shoqërinë “Albpetrol” SH.A. 1

Realizim i videove informuese lidhur me 5 vendburimet e prodhimit të naftës që janë në administrim të “Albpetrol” SH.A. 5

Realizim i videove informuese dhe promovuese të Reparteve Prodhuese dhe Shërbimeve të “Albpetrol” SH.A. 5

Realizim i arkivit të përmbajtjes vizuale dhe multimediale për marketingun digital dhe rrjetet sociale për t'u përdorur në të gjithë harkun kohor të 1 (një) viti ku përfshihen: 1 30 video montazhe 30

b. 100 fotografi profesionale 100

c. 120 designe për postime 120

Shohim që për zërin 4 “Realizim i arkivit të përmbajtjes vizuale dhe multimediale për marketingun digital dhe rrjetet sociale për t'u përdorur në të gjithë harkun kohor të 1 (një) viti ku përfshihen:” është vendosur sasia 1 cope, ndërkohë që ky zë është ndarë në pikat a, b dhe c. Për zërin 4 në vetvete është përmbledhje e tre pikave a, b, c, ku secila prej tyre ka sasi të përcaktuara 30, 100, 120 cope, por ndërkohë ka edhe sasia 1 cope tek zëri 4, që do të thotë që nëse si ofertues duhet të vendosim cmim edhe tek zëri 4, edhe tek zerrat a, b, c.

*Kjo gje eshte e paqarte, mendojme se sasia “1 cope” te zeri “Realizim i arkivit te permbajtjes vizuale dhe multimediale per marketingun digital dhe rrjetet sociale per t'u perdorur ne te gjithë harkun kohor të 1 (një) viti ku përfshihen:” eshte vendosur gabimisht dhe duhet te hiqet, dhe ne si OE nuk duhet te ofertojme per zerin 4, por duhet te ofertojme per zerat a, b, c. Lutemi na sqaroni ne lidhje me kete pike: nese duhet te ofertojme per zerin 4 lutemi na sqaroni cfare sherbimesh te tjera, vec atyre te renditura ne pikat a, b, c, perfshin zeri 4.*

#### **ARSYETIMI I KSHA:**

1. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit dhe konsultimi me specialistët e fushës që kanë hartuar specifikimet teknike dhe termat e referencës, përsa i përket problematikës 1.1 të pikës 1 të ankesës së OE, që Hartimi i Strategjisë së Marketingut Dixhital nuk është përfshirë në tabelën e produkteve të procedurës dhe as nuk jepen sqarime apo specifikime për këtë pikë, KSHA argumenton se: Hartimi i Strategjisë së Marketingut Dixhital të shoqërisë “Albpetrol” SH.A ka si qëllim hartimin e një plani marketingu për shoqërinë “Albpetrol” SH.A në formën e një strukturë të përgjithshme që do të orientojë kompaninë në promovimin e mallrave apo shërbimeve të saj në tregun e saj të synuar, si dhe promovimin e aktivitetit të saj të përditshëm dhe të investimeve që do të ndikojnë në përmirësimin e kushteve të punës së punonjësve të saj, si edhe të jetesës së komunitetit përreth.

a. Strategjia e Marketingut Dixhital duhet që të kombinojë elemente të qartë marketingu, të cilët do të ndihmojnë shoqërinë “Albpetrol” SH.A që të përputhet në mënyrë efikase me burimet që ka dhe përpjekjet e saj për të arritur objektiva të veçanta.

b. Strategjia e Marketingut Dixhital duhet që të përcaktojë metodat që do të aplikohen/përdoren që marketingu i shoqërisë “Albpetrol” SH.A (referohu qëllimit në paragrafin më lart) të funksionojë dhe po kështu të projektohen hapat posaçërisht për tregun/publikun në varësi të qëllimit.

Përsa më lart, duke qënë se Strategjia e Marketingut Dixhital duhet që të hartohet nga ekspert teknik dhe të specializuar në këtë fushë, si dhe për rrjedhojë për hartimin e saj do të përdoren burime njerëzore e për pasojë do të duhet kohë pune, të cilat të dyja bashkë do të përkthehen në vlerë monetare,

KSHA vlerëson që ky pretendim i ankimesit për pikën 1.1 qëndron. Njësia e prokurimit të reflektojë ndryshimet me hartimin e një shtojce në DST.

2. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit dhe konsultimi me specialistët e fushës që kanë hartuar specifikimet teknike dhe termat e referencës, përsa i përket problematikës 1.2 të pikës 1 të ankesës së OE, që zëri “Realizim i arkivit të përmbajtjes vizuale dhe multimediale për Albpetrol sh.a. NUIS J82916500U Selia Rr. “Fier-Patos”, Km. 7, Patos T +3553813662 F marketingun digital dhe rrjetet sociale për t'u përdorur..., në formularin e shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit është trajtuar si përmbledhës për nënzërat...”, KSHA argumenton se:

Në këtë rast është e qartë që do të ofertohet për nënzërat duke përcaktuar vlerë ofertimi në listën e çmimeve për secilin nga këta nënzëra. Totali (shumatorja) i këtyre 3 (tre) nënzërave do të jetë i përcaktuar me ofertë për zërin kryesor “Realizim i arkivit të përmbajtjes vizuale dhe multimediale për marketingun digital dhe rrjetet sociale për t'u përdorur në të gjithë harkun kohor të 1 (një) viti”.

*Por për saktësimin e saj dhe për shmangien e çdo problematike apo keqinterpretimi që mund të lind nga ky përshkrim,*

*KSHA vlerëson që ky pretendim i ankimuesit për pikën 1.2 qëndron. Njësia e prokurimit të reflektojë ndryshimet me hartimin e një shtojce në DST. ”*

III.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.*

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se : *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

*a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:*

*i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;*  
*ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

*b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

*c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.*

*2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën për dokumentet e tenderit dhe në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/ klasifikimit kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon procedurën për pjesën tjetër të ankesës dhe me mbylljen e shqyrtimit të çështjes duhet të shprehet me vendimmarrje deklarative për pjesën e pranuar sipas parashikimeve të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 118 të këtij ligji, së bashku me vendimmarrje për pjesën tjetër.”*

III.1.4. Sa më sipër, referuar nenit 115 të Ligjit Nr. nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, vendos të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Optima Communication” SHPK dhe do të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pretendimet e tjera të paraqitura në ankesë.

### III.2. Lidhur me pretendimet e ankimuesit:

#### *“PROBLEMATIKA 2.1*

*Sikurse verehet nga specifikimet teknike te procedures dhe nga lista e produkteve, shërbimet qe kerkohen jane te shumta dhe te nje natyre te tille qe kerkojne kohen e tyre per tu realizuar. Kerkohet qe OE te realizojne filmime ne shume pika, filmimet do te jene me kamera dhe me dron: Sekuenca të filmuara me kamera në lartësi nëpërmjet dronit. Sekuenca të filmuara në nivelin e syrit apo të tokës. Të kenë skena nga objektet kryesore të shoqërisë “Albpetrol” SH.A.*

*Video 1 - Vendburimin Kuçovë,*

*Video 2 - Vendburimin Cakran në Mollaj,*

*Video 3 - Vendburimin Gorisht në Kocul*

*Video 4 - Vendburimin Amonicë,*

*Video 5 - Vendburimin Patos.*

*Video 1 - Qendra e Emergjencave të Naftës dhe Gazit (Q.E.M.N.G) Patos,*

*Video 2 - Qendra e Furnizimit Teknik (Q.F.T) Patos,*

*Video 3 - Qendra e Shërbimit Gjeologjik (Q.SH.GJ) Patos,*

*Video 4 - Qendra e Furnizimit dhe Shërbimit Elektrik (Q.F.SH.E) Patos,*

*Video 5 - Qendra Mekanike e Naftës (Q.M.N) Kuçovë.*

*Ne specifikimet teknike gjithashtu kerkohet:*

*Operatori Ekonomik duhet të krijojë konceptin, skenarin dhe storyboard-in e spotit televiziv. Përpara përgatitjes së videove, operatori ekonomik duhet të prezantojë një ide nëpërmjet një ‘storyboard’, i cili duhet të ketë në përmbajtje ideimin, krijimin dhe skenarin e spotit korporativ. Kerkohen vec videove kryesore edhe 30 video montazhe, 100 fotografi profesionale, 120 designe për postime, ku vetem ideimi dhe realizimi i 120 dizajneve kerkon minimalisht 30 dite. Ne keto kushte kerkojme qe afati i realizimit te shërbimeve te jete se paku 120 dite, ne menyre qe ti lihet OE koha per te punuar. Sjellim ne vemendje qe realizimi i filmimeve eshte ne varesi te kushteve atmosferike, te cilat tani ne periudhen e pranveres jane te paqendrueshme, prandaj vetem per te filluar punen me filmimet mund te linde nevoja te pritet me dite te tera permiresimi i kushteve te motit. Pastaj realizimi i filmimeve ne se paku 10 pika filmimesh kerkon minimalisht dy jave pune. Me tej perpunimi, projektimi, ideimi dhe realizimi i 11 videove (me efekte zanore, grafike, narracion, perkthim, etj) gjithashtu kerkon kohen prej minimalisht dy muaj. Dhe se fundmi 120 punime dizajn kerkojne se paku 45 dite. Ne proces-verbalin e argumentimit te kriterave nuk gjejmë ndonje sqarim pse eshte vendosur nje afat kaq i shkurter levrimi, nderkohe qe materialet qe do te prodhohen do te perdoren per publikime gjate 1 viti, pra ne nje periudhe mjaftueshem te gjate, nuk jane urgjente.*

*PROBLEMATIKA 2.2 Ne specifikimet teknike per videon 1 kerkohet: Operatori Ekonomik duhet të krijojë konceptin, skenarin dhe storyboard-in e spotit televiziv. Përpara përgatitjes së videove, operatori ekonomik duhet të prezantojë një ide nëpërmjet një “storyboard”, i cili duhet të ketë në përmbajtje ideimin, krijimin dhe skenarin e spotit korporativ. Lutemi koha qe merr AK per te konfirmuar konceptin, skenarin dhe storyboard-in e spotit televiziv te mos perfshihet ne afatin e levrimit qe ka ne dispozicion OE, pasi AK mund te kete nevoje ta studioje propozimin dhe ky*

proces mund të kerkoje dite të tera. Natyrisht AK mund të marre kohen që i nevojitet, por ky afat/keto dite, të mos përfshihen në afatin e levritimit të OE.

### **PROBLEMATIKA 2.3**

Ne shojcën 6 FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE dhe ne shojcën 8 FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS, për zerat 1, 2, 3, kerkohet: Operatori Ekonomik duhet të sigurojë të gjithë infrastrukturën e nevojshme për realizimin e videove: transportin, stafin dhe lejet e xhirimit në secilat prej pikave të shoqërisë “Albpetrol” SH.A të parapërcaktuara për xhirime. Lutemi na sqaroni çfarë do të thote që OE duhet të sigurojë leje nga Albpetrol për të realizuar filmime në pikat e Albpetrol, nderkohe që mes OE dhe Albpetrolit do të jete një kontrate të firmosur mes paleve dhe vete Albpetrol ka kerkuar që OE të beje keto xhirime dhe ka percaktuar pikat e xhirimit. Nuk e kuptojme për çfarë leje e keni fjalën. Sipas udhëzimeve të APP një AK nuk duhet ti kerkoje OE dokumenta të cilat i zoteron vete AK, sic është kjo leje. ”KPP vëren se

III.2.1. Në shojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

#### **Shojca 6.**

*[ Shojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor ]*

### **FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

**Objekti kryesor:** Përcjellja e mesazhit se shoqëria “Albpetrol” SH.A ka përmirësuar qëndrimet dhe proceset ndaj mjedisit, duke minimizuar ndotjen dhe duke investuar në teknologji të reja për të mbrojtur ambientin.

#### **A. Përshkrimi sasior i shërbimeve që kërkohen:**

1. Realizim i 1 (një) video të përgjithshme korporative për shoqërinë “Albpetrol” SH.A.
2. Realizim i 5 (pesë) videove informuese lidhur me 5 vendburimet e prodhimit të naftës që janë në administrim të “Albpetrol” SH.A.
3. Realizim i 5 (pesë) videove informuese dhe promovuese të Reparteve Prodhuese dhe Shërbimeve të “Albpetrol” SH.A.
4. Realizim i arkivit të përmbajtjes vizuale dhe multimediale për marketingun digital dhe rrjetet sociale për t’u përdorur në të gjithë harkun kohor të 1 (një) viti ku përfshihen:
  - 30 video montazhe
  - 100 fotografi profesionale
  - 120 designe për postimeKjo përmbajtje do të përfshijë: Përdorimi i "Stories" dhe "Highlights" për të krijuar kategori të veçanta, si "Mjediti", "Teknologjia e Re", "Punonjësit Tanë" dhe “Dita në jetën e punonjësve tanë”.
5. Hartimi i Strategjisë së Marketingut Dixhital të shoqërisë “Albpetrol” SH.A.

#### **B. Përshkrimi teknik i shërbimeve që kërkohen:**

➤ **Realizim i 1 (një) VIDEO të përgjithshme korporative për shoqërinë “Albpetrol” SH.A. Specifikimet teknike kërkohen si më poshtë:**

- Video Spot TV me gjatësi 60 sekonda. Kjo video korporative duhet të ketë në fokus rolin historik të shoqërisë “Albpetrol” SH.A në industrinë shqiptare, përpjekjet mjedisore dhe investimet në teknologji të reja. Të përçojë historinë, vizionin dhe përpjekjet për një të ardhme të qëndrueshme të shoqërisë “Albpetrol” SH.A, si dhe të ndërtojë një imazh pozitiv dhe të unifikuar të kompanisë.
- Të tregojë dhe përcjellë një raport të rregullt të shoqërisë “Albpetrol” SH.A mbi ndikimin mjedisor dhe përmirësimet e arritura, me qëllim forcimin e besimit të kompania.
- Operatori Ekonomik duhet të krijojë konceptin, skenarin dhe storyboard-in e spotit televiziv.
- Përpara përgatitjes së videove, operatori ekonomik duhet të prezantojë një ide nëpërmjet një ‘storyboard’, i cili duhet të ketë në përmbajtje ideimin, krijimin dhe skenarin e spotit korporativ.
- Spoti duhet të realizohet në përputhje me standartet dhe teknikat më të avancuara të filmimeve të kësaj natyre dhe duhet të jetë i përshtatshëm për formatin e transmetimit në High Definition.
- Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë dhe 2 (dy) versione të tjera të spotit: versionin 30 sekonda dhe një spot 10 sekonda.
- Për spotin, operatori ekonomik duhet të marri përsipër që pamjet që do të regjistrohen gjatë periudhës së xhirimeve duhet të jenë ekskluzive në pronësi të shoqërisë “Albpetrol” SH.A. Xhirimet duhet të përmbajnë:
  - a. Sekuenca të filmuara me kamera në lartësi nëpërmjet dronit.
  - b. Sekuenca të filmuara në nivelin e syrit apo të tokës.
  - c. Të kenë skena nga objektet kryesore të shoqërisë “Albpetrol” SH.A.
  - d. Të jenë një kombinim midis xhirimeve të ndryshme dhe elementeve grafik të animuar.
  - e. Muzikë, Audio/narracion shoqëruar me copyright;
  - f. Spoti duhet të jetë në formatin MPEG 2 me CBR 35 dhe H 264 me CBR 35, me rezolucione 16 \* 9 (1920 x 1080 px)
  - g. Regjistrim profesional të zërit. Efektet audio (SFX) dhe kolona zanore duhet të përmbushin standartin teknik sipas parametrave: 48 khz dhe 24 bit depth.
- Efektet audio dhe efektet muzikore në përmbajtje të materialit përfundimtar duhet të jenë të trajtuar posaçërisht për Spotin TV dhe të zotërojnë të gjitha të drejtat e rezervuara të përdorimit të pakufizuar, si në aspektin gjeografik ashtu edhe në aspektin kohor.
- Spoti TV duhet të përmbajë sloganin kryesor, logon zyrtare dhe websitin zyrtar të shoqërisë “Albpetrol” SH.A, i cili është [www.albpetrol.al](http://www.albpetrol.al).
- Spoti TV duhet të ketë në përbërje të tij tekst përshkruar në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze.

- Operatori Ekonomik duhet të sigurojë të gjithë infrastrukturën e nevojshme për realizimin e Spotit TV: transportin, stafin dhe lejet e xhirimit në secilat prej pikave të shoqërisë “Albpetrol” SH.A të parapërcaktuara për xhirime.
- Masterat e Spotit TV duhet të dorëzohen në formatin MPEG 2, MP4, me rezolucion 16/9 (1920 x 1080px) në USB ose në Hardisk.
- **Realizim i 5 (pesë) videove informuese, respektivisht lidhur me 5 (pesë) vendburimet prodhuese të naftës që janë në administrim të “Albpetrol” SH.A. Specifikimet teknike kërkohen si më poshtë:**
  - Këto video duhet të kenë në fokus të informojnë publikun mbi rëndësinë e këtyre vendburimeve dhe përpjekjet për të minimizuar ndikimin mjedisor. Realizimi i këtyre videove duhet të jenë në formatin dhe konceptin e përshtatshëm për t’u publikuar në **ëeb**, rrjete sociale, si dhe në prezantime në evente apo takime të ndryshme.
  - Videot duhet të trajtojnë dhe të jenë të dedikuara për:
    - a. Video 1 - **Vendburimin Kuçovë,**
    - b. Video 2 - **Vendburimin Cakran – Mollaj,**
    - c. Video 3 - **Vendburimin Gorisht –Kocul,**
    - d. Video 4 - **Vendburimin Amonicë,**
    - e. Video 5 - **Vendburimin Patos.**
  - Të 5 (pesë) videot duhet të jenë në një gjatësi jo më të vogël se 45 sekonda secila.
  - Të gjitha videot duhet të realizohen në përputhje me standartet dhe teknikat më të avancuara të filmimeve të kësaj natyre dhe duhet të jenë të përshtatshme për formatin e transmetimit në High Definition.
  - Pamjet që do të regjistrohen gjatë periudhës së xhirimeve duhet të jenë ekskluzive në pronësi të shoqërisë “Albpetrol” SH.A. Xhirimet duhet të përmbajnë:
    - a. Sekuenca të filmuara me kamera në lartësi nëpërmjet dronit.
    - b. Sekuenca të filmuara në nivelin e syrit apo të tokës.
    - c. Të kenë skena nga vendburimet e shoqërisë “Albpetrol” SH.A.
    - d. Të jenë një kombinim midis xhirimeve të ndryshme dhe elementeve grafik të animuar.
    - e. Muzikë, narracion shoqërues me copyright, tekst përshkrues në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze.
    - f. Regjistrim profesional zeri. Efektet audio (SFX) dhe kolona zanore duhet të përmbushin standartin teknik sipas parametrave: 48 khz dhe 24 bit depth.
  - Operatori Ekonomik duhet të sigurojë të gjithë infrastrukturën e nevojshme për realizimin e të 5 (pesë) videove: transportin, stafin dhe lejet e xhirimit në secilat prej pikave të shoqërisë “Albpetrol” SH.A të parapërcaktuara për xhirime.
  - Videot duhet të përmbajnë emrin e vendburimit, duhet të përmbajnë sloganin kryesor, logon zyrtare dhe websitin zyrtar të shoqërisë “Albpetrol” SH.A, i cili është [www.albpetrol.al](http://www.albpetrol.al).

- Masterat e Videove duhet të dorëzohen në formatin MPEG 2, MP4, me rezolucion 16/9 (1920 x 1080px) në USB ose në Hardisk.
- **Realizim i 5 (pesë) videove informuese dhe promovuese të Reparteve Prodhuese dhe Shërbimeve të “Albpetrol” SH.A. Specifikimet teknike kërkohen si më poshtë:**
  - Videot duhet të kenë në fokus prezantimin e kapaciteteve teknike, modernizimin e reparteve prodhuese dhe shërbimeve, si dhe perspektivën e zhvillimit të teknologjisë dhe standarteve teknik për të rritur besueshmërinë dhe interesin publik.
  - Videot duhet të trajtojnë dhe të jenë të dedikuara për:
    - a. Video 1 - **Qendra e Emergjencave të Naftës dhe Gazit (Q.E.M.N.G) Patos,**
    - b. Video 2 - **Qendra e Furnizimit Teknik (Q.F.T) Patos,**
    - c. Video 3 - **Qendra e Shërbimit Gjeologjik (Q.SH.GJ) Patos,**
    - d. Video 4 - **Qendra e Furnizimit dhe Shërbimit Elektrik (Q.F.SH.E) Patos,**
    - e. Video 5 - **Qendra Mekanike e Naftës (Q.M.N) Kuçovë.**
  - Të 5 (pesë) videot duhet të jenë në një gjatësi jo më të vogël se 60 sekonda secila.
  - Të gjitha videot duhet të realizohen në përputhje me standartet dhe teknikat më të avancuara të filmimeve të kësaj natyre dhe duhet të jenë të përshtatshme për formatin e transmetimit në High Definition.
  - Pamjet që do të regjistrohen gjatë periudhës së xhirimeve duhet të jenë ekskluzive në pronësi të shoqërisë “Albpetrol” SH.A. Xhirimet duhet të përmbajnë:
    - a. Sekuenca të filmuara me kamera në lartësi nëpërmjet dronit.
    - b. Sekuenca të filmuara në nivelin e syrit apo të tokës.
    - c. Të kenë skena nga vendburimet e shoqërisë “Albpetrol” SH.A.
    - d. Të jenë një kombinim midis xhirimeve të ndryshme dhe elementeve grafik të animuar.
    - e. Muzikë, narracion shoqërues me copyright, tekst përshkrues në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze.
    - f. Regjistrim profesional zeri. Efektet audio (SFX) dhe kolona zanore duhet të përmbushin standartin teknik sipas parametrave: 48 khz dhe 24 bit depth.
  - Operatori Ekonomik duhet të sigurojë të gjithë infrastrukturën e nevojshme për realizimin e të 5 (pesë) videove: transportin, stafin dhe lejet e xhirimit në secilat prej pikave të shoqërisë “Albpetrol” SH.A të parapërcaktuara për xhirime.
  - Videot duhet të përmbajnë emrin e vendburimit, duhet të përmbajnë sloganin kryesor, logon zyrtare dhe websitin zyrtar të shoqërisë “Albpetrol” SH.A, i cili është [www.albpetrol.al](http://www.albpetrol.al).
  - Masterat e Videove duhet të dorëzohen në formatin MPEG 2, MP4, me rezolucion 16/9 (1920 x 1080px) në USB ose në Hardisk.
- **Realizim i arkivit të përmbajtjes vizuale dhe multimediale për marketingun digital dhe rrjetet sociale, për t’u përdorur në të gjithë harkun kohor të 1 (një) viti ku përfshihen:**
  - 30 video montazhe
  - 100 fotografi profesionale
  - 120 designe për postime

Specifikimet teknike kërkohen si më poshtë:

- Videot, fotografitë dhe designet e postimeve duhet të përmbajnë tematika dhe imazhe nga terrenet dhe projektet ku përfshihen punonjësit e shoqërisë “Albpetrol” SH.A, Vendburimet e shoqërisë “Albpetrol” Sh.A, Repartet prodhuese dhe shërbimeve të shoqërisë “Albpetrol” SH.A, Infografikë që tregojnë rezultate konkrete të punës dhe mesazhe në dobi të informacionit për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit.
- Krijimin dhe design të publikimeve në formate të ndryshme vizuale si imazhe ose GIF sipas standarteve të lejuara nga platforma Google Display Network dhe META.
- Formatet e të gjitha materialeve (fotografi, video, design) duhet të jenë në përmasat:

| Google Ads sizes | Facebook sizes | Instagram sizes |
|------------------|----------------|-----------------|
| 300x250px        | Post:          | Post:           |
| 300x600px        | 1080x1080px    | 1080x1080px     |
| 160x600px        | 1200x628px     | 1080x1350px     |
| 728x90px         | 1080x1920px    |                 |
| 728x250px        | 1080x1350px    | Story:          |
| 970x90px         |                | 1080x1920       |
| 970x250px        | Story:         |                 |
| 300x100px        | 1080x1920      | Reels:          |
| 300x50px         |                | 1080x1920       |
| 320x50px         | Reels:         | 1080x1350       |
| 336x280px        | 1080x1920      |                 |

- **Për krijimin e 30 (tridhjetë) video montazhe:**
  - a. Video montazhe ose gif duke i'u përshtatur formateve të kërkuara për postimet në mediat digitale (postime dhe story ne facebook dhe instagram, google ads, youtube).
  - b. Video montazhet duhet të jenë në një gjatësi jo më të vogël se 15 sekonda.
  - c. Video montazhet duhet të përmbajnë tematika dhe imazhe nga terrenet dhe projektet ku përfshihen punonjësit e shoqërisë “Albpetrol” SH.A, Vendburimet e shoqërisë “Albpetrol” Sh.A, Repartet prodhuese dhe shërbimeve të shoqërisë “Albpetrol” Sh.A, Infografikë që tregojnë rezultate konkrete të punës dhe mesazhe në dobi të informacionit për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit.
- **Për krijimin e 100 (njëqind) fotografi profesionale:**
  - a. Fotografitë profesionale të përmbajnë tematika dhe imazhe nga terrenet dhe projektet ku përfshihen punonjësit e shoqërisë “Albpetrol” SH.A, Vendburimet e shoqërisë “Albpetrol” Sh.A, Repartet prodhuese dhe shërbimeve të shoqërisë “Albpetrol” Sh.A, Infografikë që tregojnë rezultate konkrete të punës dhe mesazhe në dobi të informacionit për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit.
  - b. Fotografitë duhet të dorëzohen në formatin e një kualiteti të lartë: Minimalisht 2K dhe rezolucion 300 dpi.
- **Për krijimin e 120 (njëqind e njëzetë) designe për postime:**
  - a. Designet duhet të përmbajnë tematika dhe imazhe nga terrenet dhe projektet ku përfshihen punonjësit e shoqërisë “Albpetrol” Sh.A, Vendburimet e shoqërisë “Albpetrol” Sh.A, Repartet prodhuese dhe shërbimeve të shoqërisë “Albpetrol” SH.A,

Infografikë që tregojnë rezultate konkrete të punës dhe mesazhe në dobi të informacionit për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit.

- b. Kjo përmbajtje do të përfshijë: Përdorimi i "Stories" dhe "Highlights" për të krijuar kategori të veçanta, si "Mjedisi", "Teknologjia e Re", "Punonjësit Tanë" dhe "Dita në jetën e punonjësve tanë".

Në përmbledhje të sa më lart, shërbimi që kërkohet është sipas specifikimeve teknike në pikën B të këtij materiali dhe përshkrimit sasior në pikë A, e cila në formë tabelare është si më poshtë:

| <b>Nr</b> | <b>Përshkrimi</b>                                                                                                                                                                | <b>Sasia (Copë)</b> |
|-----------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------|
| <b>1</b>  | Realizim i videos të përgjithshme korporative për shoqërinë "Albpetrol" SH.A.                                                                                                    | 1                   |
| <b>2</b>  | Realizim i videove informuese lidhur me 5 vendburimet e prodhimit të naftës që janë në administrim të "Albpetrol" SH.A.                                                          | 5                   |
| <b>3</b>  | Realizim i videove informuese dhe promovuese të Reparteve Prodhuese dhe Shërbimeve të "Albpetrol" SH.A.                                                                          | 5                   |
| <b>4</b>  | Realizim i arkivit të përmbajtjes vizuale dhe multimediale për marketingun digital dhe rrjetet sociale për t'u përdorur në të gjithë harkun kohor të 1 (një) viti ku përfshihen: | 1                   |
| <b>a</b>  | 30 video montazhe                                                                                                                                                                | 30                  |
| <b>b</b>  | 100 fotografi profesionale                                                                                                                                                       | 100                 |
| <b>c</b>  | 120 designe për postime                                                                                                                                                          | 120                 |

Afati për dorëzimin dhe përfundimin e këtij shërbimi duhet të bëhet për një periudhë kohore jo më shumë se 30 (tridhjetë ditë) nga lidhja e Kontratës.

III. Në shtojcën 7 "Formulari i shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit" të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

**Shërbimi që kërkohet është sipas të dhënave të paraqitura në tabelën e mëposhtme:**

| <b>Nr</b> | <b>Përshkrimi</b>                                                                                                       | <b>Sasia (Copë)</b> |
|-----------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------|
| <b>1</b>  | Realizim i videos të përgjithshme korporative për shoqërinë "Albpetrol" SH.A.                                           | 1                   |
| <b>2</b>  | Realizim i videove informuese lidhur me 5 vendburimet e prodhimit të naftës që janë në administrim të "Albpetrol" SH.A. | 5                   |
| <b>3</b>  | Realizim i videove informuese dhe promovuese të Reparteve Prodhuese dhe Shërbimeve të "Albpetrol" SH.A.                 | 5                   |

|          |                                                                                                                                                                                         |            |
|----------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|
| <b>4</b> | <i>Realizim i arkivit të përmbajtjes vizuale dhe multimediale për marketingun digital dhe rrjetet sociale për t'u përdorur në të gjithë harkun kohor të 1 (një) viti ku përfshihen:</i> | <i>1</i>   |
| <b>a</b> | <i>30 video montazhe</i>                                                                                                                                                                | <i>30</i>  |
| <b>b</b> | <i>100 fotografi profesionale</i>                                                                                                                                                       | <i>100</i> |
| <b>c</b> | <i>120 designe për postime</i>                                                                                                                                                          | <i>120</i> |

#### **Afatet e ekzekutimit:**

Afati për dorëzimin dhe përfundimin e këtij shërbimi duhet të bëhet për një periudhë kohore jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nga lidhja e Kontratës.

III.2.2. Neni 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” i ndryshuar parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.2.3. Neni 3 Parime të përgjithshme 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III 2.4. Neni 21 Autoriteti ose enti kontraktor 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi

III.2.5. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët,

nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit.

III.2.6. Në rastin konkret, referuar pretendimit të ankimuesit, si dhe argumenteve të autoritetit kontraktor, KPP gjykon se afati për dorëzimin dhe përfundimin e këtij shërbimi për një periudhë kohore jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nga lidhja e kontratës i përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi nuk është i mjaftueshëm për realizimin në kohë dhe me cilësi të objektit të prokurimit duke patur parasysh llojin e shërbimit që do të kryehet (realizimin e videove, korporative, informuese, video montazheve, fotografi profesionale, dizajn per postime), si dhe faktin që këto shërbime do të kryhen në pika apo vendodhje të ndryshme të cilat duke qënë në hapësira gjeografike të ndryshme kërkojnë kohën e tyre për realizimin e shërbimit. Pavarësisht se autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes për këtë pretendim ka argumentuar se ai ka formën e organizmit si një shoqëri aksionere ku miraton programin e zhvillimit ekonomik për vitin ushtimor pranë Asamblesës së Përgjithshme program ky që efektet e tij i ka deri në datën 31.12.2025 dhe nevojat e tij janë për të promovuar shërbimet dhe investimet e programuara posacerisht për vitin 2025 si dhe zërat sipas tyre janë të ndërthurur me njëri tjetrin dhe nuk kërkojnë shumë orë në dispozicion për realizimin e tyre, KPP gjykon se duke patur parasysh natyrën e shërbimeve që do të kryhen, numrin e videomontazhe, fotografive dhe dizajneve si dhe vendodhjen e ndryshme gjeografike të pikave në të cilat do të kryhen këto shërbime, afati për dorëzimin dhe përfundimin e këtij shërbimi nga lidhja e kontratës duhet të jetë më i gjatë se ai që ka vendosur autoriteti kontraktor, në mënyrë që ofertuesve t'ju lihet koha e nevojshme për të realizuar shërbimin në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor të përcaktuara në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi. Për rrjedhojë autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e afatit për dorëzimin dhe përfundimin e këtij shërbimi nga momenti i lidhjes së kontratës në mënyrë të tillë që të nxisë pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës. Sa më lart pretendimi i ankimuesit qëndron pjesërisht.

Lidhur me pretendimin e ankimuesit *“Lutemi koha që merr AK për të konfirmuar konceptin, skenarin dhe storyboard-in e spotit televiziv të mos përfshihet në afatin e levrimit që ka ne*

*dispozicion OE, pasi AK mund te kete nevojë ta studioje propozimin dhe ky proces mund te kerkoje dite te tera.” KPP e gjykon të drejtë këtë pretendim sepse krijimi i konceptit, skenarit dhe storyboard të spotit televizi i përket një faze paraprake, pra para dhënies së shërbimit dhe si të tilla janë veprime që kërkojnë së pari konfirmimin e autoritetit kontraktor që të kalohet më pas te realizimi i shërbimit. Akoma më tej për këtë rast vetë autoriteti kontraktor në specifitime teknike ka përcaktuar që përpara përgatitjes së videove, operatori ekonomik duhet të prezantojë një ide nëpërmjet një ‘storyboard’, i cili duhet të ketë në përmbajtje ideimin, krijimin dhe skenarin e spotit korporativ, pra janë veprime paraprake përpara realizimit të shërbimit (përgatitjes) së videove dhe si të tilla nuk duhet të përfshihen në afatin e egzekutimit të shërbimit. Sa më lart prendimi i ankimuesit qëndron.*

*Lidhur me pretendimet e ankimuesit “Lutemi na sqaroni çfare do te thote qe OE duhet te siguroje leje nga Albpetrol per te realizuar filmime ne pikat e Albpetrol, nderkohe qe mes OE dhe Albpetrolit do te jete nje kontrate te firmosur mes paleve dhe vete Albpetrol ka kerkuar qe OE te beje keto xhirime dhe ka percaktuar pikat e xhirimit.” Komisioni gjykon, se objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimues për këto pretendime nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor (verifikim ligjor apo specifitim teknik në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik), por në thelb janë paqartësi mbi kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, KPP-ja konstaton, se autoriteti kontraktor, në kthimin e përgjigjes së ankesës së operatorit ekonomik ankimues, në përputhje me nenin 75 të LPP-së, i cili parashikon shprehimisht se: “Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.*

*Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit.”, ka dhënë sqarime për operatorin ekonomik ankimues, por Komisioni i sjell në vëmendje autoritetit kontraktor, se sqarimet që ka dhënë në kthimin e përgjigjes lidhur me pretendimin më sipër duhet të publikohen në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) në përputhje me përcaktimet e nenit 75 të LPP-së me qëllim që operatori ekonomik ankimues si dhe të gjithë operatorët e tjerë të cilët shfaqin interes për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit të njihen me këto sqarime. Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.*

### III.3. Lidhur me pretendimet e ankimuesit:

#### “PROBLEMATIKA 3.1

*Numri i punonjesve te kerkuar eshte shume i larte dhe ne proces verbalin e argumentimit te kritereve nuk gjejmë asnje sqarim se çfare funksioni do te kene keta 10 punonjes ne kete*

procedure, çfare pune do të bëjnë këta 10 punonjës, nuk gjejmë asnjë sqarim apo argumentim teknik përse po kerkohen kaq shumë punonjës të cilët domosdoshmërisht duhet të figurojnë në listat e pagesave. AK ka detyrimin të argumentojë ligjërisht dhe teknikisht, çfare shërbimi/pune do të kryejë secili nga 10 punonjësit e kërkuar, bazuar në zërat e procedurës. Ky kriter pengon biznesin e vogël dhe të mesëm të ofertojë në mënyrë të paargumentuar, duke kufizuar konkurrencën. Lutemi numri i punonjësve të cilët figurojnë në listat e pagesave të jetë jo më shumë se 3, në mënyrë që kriteri të jetë sa më gjithëpërfshirës.

### PROBLEMATIKA 3.2

“Eshtë kërkuar të paraqitet “Vërtetimi i lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve minimalisht për tre muajt e fundit”. Synimi i kriterit është që AK të njihet me gjendjen dhe kapacitetet aktuale të OE, jo me gjendjen që kishte para 3 muajve. Në 3 muaj situata e OE mund të ndryshojë, mund të përkeqesohet apo përmiresohet, por synimi është të njihen kapacitetet aktuale të kompanive, dhe jo të vlerësohen për kapacitet që kishin para 3 muajve. Lutemi të kerkohet Vërtetimi i lëshuar nga Administrata Tatimore për muajin e fundit.

### PROBLEMATIKA 3.3

Lutem specifikoni cilin konsideroni muaj të fundit: muajin e fundit të maturuar para shpalljes së procedurës apo muajin e fundit të maturuar para datës së zhvillimit të procedurës?” KPP vëren se,

III.3.1. Në shtojcën 9 të dokumenteve të tenderit, 2. “kriteret e veçanta të kualifikimit” 2.3 “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.2 autoriteti kontraktor ka parashikuar:

“2.3.2 Për të vërtetuar që operatori ekonomik ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë e cilësi të kontratës, duhet të ketë staf minimalisht 10 (dhjetë) punonjës.

Për këtë të paraqitet:

- Vërtetimi i lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve minimalisht për tre muajt e fundit.

**Shënim:** Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr. 10.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.”

III.3.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.3.3. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

III.3.4. Në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:
- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
  - b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
  - c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.
4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar

kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

III.3.5. Në nenin 41, pika 4 “Kërkesa të veçanta për kontratat për kontratat e shërbimeve” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme 41stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.”

III.3.6. Në procesverbalin e argumentimit të kriterëve për kualifikim dhe të specifikimeve teknike lidhur me këtë kriter autoriteti kontraktor ka argumentuar: “**Argumentimi:** Kërkesat për punonjës janë kërkuar në bazë të pikës 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku nëpërmjet këtij kriteri provohet se operatorët ekonomikë provojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. Albpetrol sh.a duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për zbatimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.”

III.3.7. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni vlerëson, se kriteret e kualifikimit duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit, natyrën, aftësinë zbatuese, vlerën si dhe përmasat/volumin e kontratës. Në rastin konkret e rëndësishme për autoritetin kontraktor, referuar natyrës së kontratës është realizimi i objektit të prokurimit në përputhje me shërbimet që kërkohen, grafikun e ekzekutimit të tyre si dhe me termat e referencës. Duke marrë shkas nga pretendimet e ankimuesit, Komisioni gjykon, se kriteri i përcaktuar në pikën 2.3.3 të kapacitetit teknik lidhur me numrin e punonjësve (10

punonjës) të shoqëruara me vërtetimin e lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve minimalisht për tre muajt e fundit, është një kërkesë e ekzagjeruar në këtë procedurë prokurimi si për sa i përket numrit ashtu dhe periudhës së kërkuar. Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë për shkaqe nga më të ndryshmet, janë të detyruar që të bëjnë ndryshime në stafin e tyre, çka cdo të thotë që kjo nuk është një e dhënë statike e pandryshueshme në kohë. Ndryshueshmëria e stafit të operatorëve ekonomikë lidhet me praktikën e brendshme të tyre dhe nuk ndikon aspak në tregues të performancës, që duhet t'i shërbejë autoritetit kontraktor si garanci në kriteret kualifikuese. Autoriteti kontraktor nuk mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë, që punonjësit për kryerjen e shërbimit të figurojnë në vërtetim e lëshuar nga administrata tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve minimalisht për tre muajt e fundit pasi operatorët ekonomike në varësi të nevojave të tyre kanë të drejtë të shtojnë apo reduktojnë staf në periudha të caktuara kohore. Gjithashtu edhe argumentimi i autoritetit kontraktor mbi përcaktimin e numrit të punonjësve nuk është i justifikuar lidhur kjo me shërbimet që kërkohen, grafikun e egzekutimit të tyre si dhe me termat e referencës. Në këtë kuadër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementeve kryesore. Së pari, nëse kërkesa në fjalë për një numër prej 10 punonjësish të shoqëruara me vërtetimin e lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve minimalisht për tre muajt e fundit është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Gjithashtu, në shqyrtimin e kriterit të mësipërm të kualifikimit, KPP gjykon të ndalet edhe në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 77 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar.

Në rastin konkret referuar objektit të prokurimit, shërbimeve që kërkohen, grafikut të egzekutimit të tyre si dhe me termave të referencës, KPP gjykon se autoriteti kontraktor në respekt të parimit të proporcionalitetit duhet të ulë numrin e punonjësve dhe të ndryshojë periudhën e kërkuar pasi për autoritetin kontraktor është e nevojshme dhe e mjaftueshme që në drejtim të plotësimit të kapacitetit teknik profesional, operatorët ekonomikë në momentin e hapjes së ofertave me anë të dokumentacionit konkret të lëshuar nga organet kompetente të provojnë, se disponojnë një numër të caktuar të punonjësve dhe gjithashtu punonjësit aktualë të jenë të siguruar, por jo të kushtëzojë operatorët ekonomikë që të vërtetojnë se disponojnë një numër prej 10 punonjësish për tre muajt e fundit. Gjithashtu lidhur me kërkesën e ankimesit që *Lutem specifikoni cilin konsideroni muaj te fundit: muajin e fundit te maturuar para shpalljes se procedures apo muajin e fundit te maturuar para dates se zhvillimit te procedures*” megjithëse kjo në thelb ka të bëjë me kërkesa për sqarim dhe jo me kundërshtimin në mënyrë të shprehur të një kriteri të hartuar nga autoriteti kontraktor, referuar arsytimit më sipër, KPP ka sqaruar se e rëndësishme është që në momentin e hapjes së ofertave operatori ekonomik të dëshmojë se ka në dispozicion stafin teknik e profesional për realizimin me sukses të kontratës dhe ndryshe nga sa shprehet autoriteti kontraktor cdo afat lidhur me kërkimet mbi disponimin e stafit teknik lidhet me momentin e hapjes së ofertave dhe jo të publikimit të njoftimit të kontratës. Sa më lart autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.2 të

kapacitetit teknik sipas konstatimeve më sipër të KPP-së duke ulur numrin punonjësve dhe duke evidentuar që e rëndësishme për autoritetin kontraktor është që në momentin e hapjes së ofertave operatorët ekonomikë të dëshmojnë se zotërojnë kapacitetet e duhura teknike e profesionale për realizimin me sukses të kontratës.

Sa më lart pretendimet e ankimuesit qëndrojnë pjesërisht.

#### III.4. Lidhur me pretendimet e ankimuesit:

##### “PROBLEMATIKA 4.1

*Punonjesit e kualifikuar janë kerkuar që të jenë domosdoshmerisht të punësuar pranë OE dhe të figurojnë në listepagesa, duke përjashtuar mundësinë që këta specialiste të kontraktohen me kontrata sherbimi/angazhimi, një mënyrë punësimi e parashikuar nga Kodi i Punës.*

*Ne proces verbalin e argumentimit të kriterëve nuk gjejmë ndonjë sqarim se në c' mënyrë do të demtohej procedura nëse këta specialiste kontraktohen me kontrate sherbimi nga OE që në momentin e ofertimit në tender. Në këtë formë që është tani kriteri është kufizues dhe bëhet pengesë për ofertim për OE, sidomos për biznesin e vogël apo të mesëm, që nuk mund të mbajë të punësuar për gjithë kohën specialiste të tilla si regjisorë apo dy dizajner, të cilët janë edhe të kushtueshëm. Lutemi të lejohet ofertimi me specialiste të kontraktuar nga ana e OE në mënyrë që kriteri të mos bëhet pengesë për ofertim dhe të jetë sa më gjithëpërfshirës.*

##### PROBLEMATIKA 4.2

*Është kerkuar të paraqiten listepagesat e tre muajve të fundit. Synimi i kriterit është që AK të njihet me gjendjen dhe kapacitetet aktuale të OE, jo me gjendjen që kishte para 3 muajve. Në 3 muaj situata e OE mund të ndryshojë, mund të përkeqësohet apo përmirësohet, por synimi është të njihen kapacitetet aktuale të kompanive, dhe jo të vlerësohen për kapacitet që kishin para 3 muajve. Lutemi të kërkohej listepagesa për muajin e fundit.*

##### PROBLEMATIKA 4.3

*Lutem specifikoni cilin konsideroni muaj të fundit: muajin e fundit të maturuar para shpalljes së procedurës apo muajin e fundit të maturuar para datës së zhvillimit të procedurës?*

*PROBLEMATIKA 4.4 Për secilin nga punonjesit e kualifikuar është kerkuar të paraqitet diploma e arsimit të lartë duke përjashtuar certifikimet apo dëshmitë e leshuara nga institucione të akredituara bazuar në ligjin për arsimin Nr.15 të Vitit 2017 “Për Arsmin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”. Në një situatë krejtësisht të njëjtë, Komisioni i Prokurimit Publik në vendimin Nr. 223/2025 datë 11.02.2025, arsyetoi: Komisioni gjykon, se ky kriter i vendosur nga autoriteti kontraktor është kufizues, pasi mënyra sesi është formuluar kriteri ka ndaluar certifikatat apo dëshmitë e tjera të leshuara nga Institucione të Akredituara, sikurse parashikon edhe ligjin Nr.15 të Vitit 2017 “Për Arsmin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”, në cilën përcaktohet qartësisht se certifikatat/dëshmitë/diplomat janë dokumente zyrtare të llojeve të ndryshme, të cilat vërtetojnë arritjet/njohurit e një specialisti për një fushë të caktuar. Pasi në nenin 16 pika 3 të ligjit Nr.15 të Vitit 2017 “Për Arsmin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”, citohet se kualifikimet e plota ose të pjesshme profesionale mund të përfitohen nëpërmjet këtyre formave: a) ndjekjes së arsimit*

profesional me bazë shkollën; b) ndjekjes së kurseve profesionale, ku përfshihen edhe praktikat profesionale në ndërmarrje apo forma të tjera të mësimnxënies praktike; c) regjistrimit si nxënës, duke u punësuar në një ndërmarrje (forma e dyfishtë); ç) njohjes të të nxënit të mëparshëm informal dhe joformal; d) njohjes të të nxënit të përfutur jashtë vendit; dh) formave të tjera të përcaktuara me ligj. Komisioni gjykon, se kërkesa e autoritetit kontraktor për një dizajner që të ketë mbaruar shkollën e lartë dhe duke përjashtuar si formim arsimin profesional është një kërkesë e ekzagjeruar, dhe nuk është në proporcion me objektin dhe qëllimin e kontratës. Komisioni gjykon, se për autoritetin kontraktor e rëndësishme është realizimi i shërbimit. Ky shërbim mund të realizohet nga një punonjës i specializuar në profesionin dizajner, me arsim profesional ashtu sikurse një specialist që ka mbaruar shkollën e lartë. Autoriteti kontraktor të rishikojë kriterin e veçantë të kualifikimit në mënyrë që të hapet konkurrenca ndërmjet operatorëve ekonomikë. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në përcaktimin/apo vendosjen e kriterëve për kualifikim ligjvënës i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe (ii) jodiskriminuese, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Duke analizuar kriterin kualifikues, Komisioni gjykon, se Autoriteti kontraktor me qëllim që të lehtësojë operatorët ekonomikë në përgatitjen e ofertave si edhe të hapë konkurrencën për operatorët ekonomikë të biznesit të mesëm dhe të vogël, duhet të modifikojë kriterin e kërkuar, në mënyrë që tu japi mundësi edhe atyre operatorëve ekonomik që disponojnë një specialist me titullin dizajner me formim profesional sipas përcaktimeve në ligjin nr.15 të vitit 2017 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”. Në këtë kuadër, KPP gjykon, se për sa kohë kërkesa e mësipërme nuk i shërben qëllimit të autoritetit kontraktor dhe shkon përtej asaj që është e nevojshme për arritjen e qëllimit, autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e kriterit në mënyrë që të hapet konkurrimi. Prandaj kërkojmë që të pranohen si deshmë edhe certifikimet apo deshmite e leshuara nga institucione të akredituara për këto profesione.

#### **PROBLEMATIKA 4.5**

Për profesionet e kërkuara: regjizor, specialist marketingu, Designer në Multimedia, diplomat/deshmite/certifikimet e leshuara mund të mos kenë saktësisht këtë emërtim. Bazuar në Ligjin për Arsimin, si edhe në Ligjin e Prokurimit Publik, neni 77: Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. kërkojmë që të pranohen diplomat/deshmite/certifikimet që provojnë se punonjësit janë specialiste të fushave të kërkuara: regjisure, marketing, dizajn, pavarësisht se si është shkruar saktësisht në diplomat/deshmite/certifikimet. Qëllimi i kriterit është që AK të njihet me kapacitet e OE dhe të bindet që OE ka në dispozicion të realizimit të procedurës profesionale të kualifikuar në fushat regjisure, marketing, dizajn, pa kushtezuar që në dokumentin provues të jete shënuar saktësisht fjale për fjale terminologjia e kërkuara nga AK specialist marketingu apo Designer në

Multimedia. Specialiste marketingu, bazuar ne VKM 514 datë 20.9.2017 Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (lqp) të rishikuar, mund te jene te gjithë te arsimuarit ne deget e ekonomise, marketingut, shitjeve, etj, po ashtu Designer në Multimedia, bazuar ne VKM 514 datë 20.9.2017 Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (lqp) të rishikuar, mund te jene te gjithë te arsimuarit ne fusha si dizajn, media, art, etj Lutemi te pranohen dokumenta provuese per arsimim ne fusha si regjisure, marketing, dizajn, sipas percaktimeve ne VKM 514 datë 20.9.2017 Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (lqp) të rishikuar.

#### PROBLEMATIKA 4.6

Lidhur me punonjesin “Specialist Marketingu”, per sa kohe qe zeri “Hartimi i Strategjisë së Marketingut Dixhital të shoqërisë “Albpetrol” SH.A.” nuk eshte i perfshire ne listen e produkteve te procedures, nuk ka arsye te kerkohet Specialist Marketingu, prandaj kerkojme qe kjo kerkese te hiqet pasi nuk eshte e argumentuar dhe nuk ka lidhje me proceduren.” KPP vëren se,

III.4.1. Në shtojcën 9 të dokumenteve të tenderit, 2.“kriteret e veçanta të kualifikimit” 2.3 “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.3 autoriteti kontraktor ka parashikuar:

“ 2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij punonjës te kualifikuar si me poshte:

- 1 (një) punonjës Regjizor
- 1 (një) punonjës Specialist Marketingu
- 2 (dy) punonjës Designer në Multimedia

Për secilin punonjës të paraqiten:

- Diploma e arsimit të lartë
- Kontratë punësimi
- Listëpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit, në të cilat punonjësit e sipërcituar duhet të figurojnë.

**Shenim:** Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet te paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojces nr. 10. Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzoje pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.”

III.4.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.4.3. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

III.4.4. Në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:
- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
  - b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
  - c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.
4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar

kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

III.4.5. Në nenin 41, pika 4 “Kërkesa të veçanta për kontratat për kontratat e shërbimeve” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme 41stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.”

III.4.6. Në procesverbalin e argumentimit të kriterëve për kualifikim dhe të specifikimeve teknike lidhur me këtë kriter autoriteti kontraktor ka argumentuar: “**Argumentimi:** Kërkesat për punonjës të certifikuar janë kërkuar në bazë të pikës 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku nëpërmjet këtij kriteri provohet se operatorët ekonomikë provojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. Albpetrol sh.a duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për zbatimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar. Kërkesat për punonjësit e mësi/përm janë hartuar duke iu referuar termave të referencës.”

III.4.7. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni vlerëson, se kriteret e kualifikimit duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit, natyrën, aftësinë zbatuese, vlerën si dhe përmasat/volumin e kontratës. Në rastin konkret e rëndësishme për autoritetin kontraktor, referuar natyrës së kontratës është realizimi i

objektit të prokurimit në përputhje me shërbimet që kërkohen, grafikun e egzekutimit të tyre si dhe me termat e referencës.

Lidhur me pretendimet e ankimuesit që të lejohet ofertimi me specialist të kontraktuar me kontaktë shërbimi për profilet regjizor, specialist marketingu dhe dizajner multimedia dhe jo domosdoshmërisht të jenë të punësuar pranë operatorit ekonomik dhe të figurojnë në listëpagesa, KPP gjykon se bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, për sa i përket rastit konkret është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimale të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Referuar testit të proporcionalitetit vendosja e kriterëve nga ana e autoritetit kontraktor duhet të jetë në proporcion me objektin e prokurimit dhe në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Duhet të ekzistojë një raport i arsyeshëm i kriterëve të vendosura dhe realizimit me sukses të kontratës. Duke e parë në këtë këndvështrim KKP gjykon, se vendosja e këtij kriteri që operatorët ekonomikë të disponojnë punonjës të profileve më sipër të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e e shoqërisë për tre muajt e fundit është kërkesë e ekzagjeruar, pasi e rëndësishme për autoritetin kontraktor është që operatorët ekonomikë që në momentin e hapjes së ofertave të disponojnë punonjës të specializuar për realizimin e kontratës objekt-prokurimi në kohë dhe me cilësi të cilët të jenë punonjës efektivë për sa kohë do të zgjasë realizimi i kontratës dhe duke e parë në këtë aspekt nuk është e domosdoshme që punonjësit e profileve më sipër të jenë domosdoshmërisht të punësuar me kohë të plotë duke figuruar në listpagesat e shoqërisë pasi operatori ekonomik mund të lidhë edhe kontrata të përkohshme me profilet e mësipërme të punonjësve për kohën e vlefshmërisë së kontratës me qëllim që profilet e kërkuara të ketë në dispozicion gjatë kësaj kohe për realizimin në kohë dhe me sukses të kontratës. Sa më lart autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për të rishikuar kriterin duke pranuar që punonjësit e mësipërm të figurojnë në listpagesat e shoqërisë ose të jenë siguruar përmes kontratës së shërbimit/angazhimit të vlefshme gjatë kohës së realizimit të kontratës. Sa më lart pretendimi i ankimuesit qëndron.

Lidhur me pretendimin e ankimuesit që *“Lutemi të kërkohet listapgesa për muajn e fundit”* KPP gjykon se autoriteti kontraktor nuk mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë, që punonjësit e profileve më sipër për kryerjen e shërbimit të figurojnë në vërtetim e lëshuar nga administrata tatimore, për tre muajt e fundit pasi operatorët ekonomike në varësi të nevojave të tyre kanë të drejtë të shtojnë apo reduktojnë staf në periudha të caktuara kohore apo të kenë në dispozicion me kontratë shërbimi/angazhimi çfarë do të thotë që jo domosdoshmërisht duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë dhe për autoritetin kontraktor është e nevojshme dhe e mjaftueshme që në drejtim të plotësimit të kapacitetit teknik profesional, operatorët ekonomikë në momentin e hapjes së ofertave të dëshmojnë që zotërojnë profilet e mësipërme. Sa më lart pretendimi i ankimuesit qëndron.

Gjithashtu lidhur me kërkesën e ankimuesit që *Lutem specifíkoni cilin konsideroni muaj te fundit: muajin e fundit te maturuar para shpalljes se procedures apo muajin e fundit te maturuar para dates se zhvillimit te procedures*” megjithëse kjo në thelb ka të bëjë me kërkesa për sqarim

dhe jo me kundërshtimin në mënyrë të shprehur të një kriteri të hartuar nga autoriteti kontraktor, referuar arsyetimit më sipër, KPP ka sqaruar se e rëndësishme është që në momentin e hapjes së ofertave operatori ekonomik të dëshmojë se ka në dispozicion stafin teknik e profesional për realizimin me sukses të kontratës dhe ndryshe nga sa shprehet autoriteti kontraktor cdo afat lidhur me kërkimet mbi disponimin e stafit teknik lidhet me momentin e hapjes së ofertave dhe jo të publikimit të njoftimit të kontratës.

Lidhur me pretendimin e ankimuesit që për profilet më sipër *“të pranohen si dëshmi edhe certifikimet apo dëshmitë e lëshuara nga institucione të akredituara për këto profesione”*, KPP gjykon se mënyra sesi është hartuar kriteri në pikën 2.3.3 të kapacitetit teknik ku kërkon që profilet regjizor, specialist marketingu dhe designer në multimedia të kenë diplomë të arsimit të lartë është kufizues, pasi ka ndaluar çertifikatat apo dëshmitë e tjera të lëshuara nga Institucione të Akredituara, sikurse parashikon edhe ligjin Nr.15 të Vitit 2017 “Për Arsmin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”, në cilën përcaktohet qartësisht se certifikatat/dëshmitë/diplomat janë dokumente zyrtare të llojeve të ndryshme, të cilat vërtetojnë arritjet/njohurit e një specialisti për një fushë të caktuar. Në nenin 16 pika 3 të ligjit Nr.15 të Vitit 2017 “Për Arsmin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”, citohet se kualifikimet e plota ose të pjesshme profesionale mund të përfitohen nëpërmjet këtyre formave: a) ndjekjes së arsimit profesional me bazë shkollën; b) ndjekjes së kurseve profesionale, ku përfshihen edhe praktikat profesionale në ndërmarrje apo forma të tjera të mësimnxënies praktike; c) regjistrimit si nxënës, duke u punësuar në një ndërmarrje (forma e dyfishtë); ç) njohjes të të nxënës të mëparshëm informal dhe joformal; d) njohjes të të nxënës të përfutur jashtë vendit; dh) formave të tjera të përcaktuara me ligj.” Komisioni gjykon, se kërkesa e autoritetit kontraktor për profilet më sipër që të kenë diplomë të arsimit të lartë duke përjashtuar si formim arsimin profesional është një kërkesë e ekzagjeruar, dhe nuk është në proporcion me objektin dhe qëllimin e kontratës. Komisioni gjykon, se për autoritetin kontraktor e rëndësishme është realizimi i shërbimit. Ky shërbim mund të realizohet nga një punonjës i specializuar në profilet më sipër me arsim profesional ashtu sikurse një specialist që ka mbaruar arsimin e lartë. Duke analizuar kriterin kualifikues, Komisioni gjykon, se Autoriteti kontraktor me qëllim që të lehtësojë operatorët ekonomikë në përgatitjen e ofertave si edhe të hapë konkurrencën për operatorët ekonomikë të biznesit të mesëm dhe të vogël, duhet të modifikojë kriterin e kërkuar, në mënyrë që tu japë mundësi jo vetëm operatorëve ekonomikë që i disponojnë profilet më sipër me diplomë të arsimit të lartë por edhe atyre operatorëve ekonomikë që i disponojnë këta specialist me formim profesional sipas përcaktimeve në ligjin nr.15 të vitit 2017 “Për Arsmin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”. Sa më lart pretendimi ankimuesit qëndron.

Lidhur me pretendimin e ankimuesit *“Kërkojmë që të pranohen diplomat/dëshmitë/certifikimet që provojnë se punonjësit janë specialist të fushave të kërkuara: regjistrim, marketing, dizajn, pavarësisht se si është shkruar saktësisht në diplomat/dëshmitë/certifikimet”* KPP gjykon se bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, për sa i përket rastit konkret është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në

legjislaconin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Referuar testit të proporcionalitetit vendosja e kriterëve nga ana e autoritetit kontraktor duhet të jetë në proporcion me objektin e prokurimit dhe në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Duhet të ekzistojë një raport i arsyeshëm i kriterëve të vendosura dhe realizimit me sukses të kontratës. Duke e parë në këtë këndvështrim KPP gjykon ,se vendosja e këtij kriteri që operatorët ekonomikë të disponojnë punonjës të profileve më sipër është një kërkesë e drejtë por autoriteti kontraktor me qëllim rritjen e konkurrencës dhe sigurimin e pjesëmarrjes së një numri sa më të gjërë pjesëmarrësish në procedurën e prokurimit duhet të marrë masa për modifikimin e këtij kriteri duke parashikuar që në diplomat/dëshmitë/certifikimet mund të parashikohen emertesa të tjera (profesione alternative) mjafton që ato të kryejnë të njëjtën natyrë punë si regjizori, specialisti i marketingut dhe dizanjeri multimedia, referuar objektit të kontratës dhe listës kombëtare të profesioneve sipas VKM nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP) të rishikuar” në funksion të realizimit në kohë dhe cilësi të kontratës. Sa më lart pretendimi i ankimuesit qëndron.

Lidhur me pretendimin e ankimuesit që “Për sa kohë që zëri “Hartim i Strategjisë së Marketingut digjital të shoqërisë ‘Albpetrol’ SHA nuk është i përfshirë në listën e produkteve të procedurës nuk ka arsye të kërkohej specialist marketingu parandaj kërkojmë që kjo kërkesë të hiqet pasi nuk ka lidhje me procedurën” KPP se operatori ekonomik ankimues është kontradiktor në kërkimet e tij në lidhje me këtë profil pasi në pretendimet më sipër të shprehura në ankesë nga njëra anë kërkon që profili i mësipërm sëbashku me profilet e tjera (regjizor dhe dizajner në multimedia) të mund të kërkohej edhe përmes kontratës së shërbimit dhe jo domosdoshmërisht të figurojë në listëpagesat e shoqërisë ndërsa në këtë rast kërkon heqjen e kësaj kërkesë. Pavarësisht kontraditës së ankimuesit në lidhje me këtë kërkesë, KPP gjykon se refuzuar procedurës së prokurimit, zërave të shërbimit si dhe grafikut të egzekutimit kjo kërkesë është proporcionale dhe në përputhje me volmin dhe përmasat e kontratës dhe si rrjedhim pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

### III.5. Lidhur me pretendimin e ankimuesit:

#### PROBLEMATIKA 5.1

*Ne formularin e specifikimeve teknike, pika “Realizim i 1 (një) VIDEO të pergjithshme korporative për shoqërinë “Albpetrol” SH.A.” autoriteti kontraktor citon: f. Spoti duhet të jetë në formatin MPEG 2 me CBR 35 dhe H.264 me CBR 35 Ne lidhje me kete pike, MPEG-2 eshte kodek shume I vjeter. I lutemi AK-se te mbaje te vemendje qe version me I ri I diteve te sotme ka shkuar ne MPEG-5. Nderkohe versioni MPEG-4 ñ eshte me I perdorshmi aktualisht për internet, mobile, dhe streaming. Ju lutem AK te kerkoje formatin e videos MPEG-4 dhe te heqe kerkesen per MPEG-2. CBR 35 (Constant Bit Rate 35 Mbps) tregon se bitrati i videos do të jetë konstant në 35 megabit për sekondë. Ky është një bitrat mjaft i lartë, i përshtatshëm për transmetime televizive ose arkivim, por mund te shkaktoje probleme ne transmetim për rrjete sociale, sikurse dhe flitet ne kete procedure. I lutemi AK te ule bitrate pasi videot nuk do jene pjese e*

trasnmetimeve televizive dhe per kete arsye nuk ka perse te rrise kostot fiktivisht. Per me teper, shumica e platformave sociale nuk mbështesin CBR 35 Mbps: YouTube rekomandon H.264 me bitrat 8-12 Mbps për 1080p dhe 20 Mbps për 4K, Facebook dhe Instagram rekomandojnë bitrat 4-6 Mbps për 1080p, Google ads 8-12 Mbps për 1080p, TikTok dhe Tëitter preferojnë bitrat më të ulët, shpesh midis 3-5 Mbps” KPP vëren se,

III.5.1. Në shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

#### **Shtojca 6.**

*[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]*

#### **FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

➤ ***Realizim i 1 (një) VIDEO të pergjithshme korporative për shoqërinë “Albpetrol” SH.A. Specifikimet teknike kërkohen si më poshtë:***

- Video Spot TV me gjatësi 60 sekonda. Kjo video korporative duhet të ketë në fokus rolin historik të shoqërisë “Albpetrol” SH.A në industrinë shqiptare, përpjekjet mjedisore dhe investimet në teknologji të reja. Të përçojë historinë, vizionin dhe përpjekjet për një të ardhme të qëndrueshme të shoqërisë “Albpetrol” SH.A, si dhe të ndërtojë një imazh pozitiv dhe të unifikuar të kompanisë.
- Të tregojë dhe përcjellë një raport të rregullt të shoqërisë “Albpetrol” SH.A mbi ndikimin mjedisor dhe përmirësimet e arritura, me qëllim forcimin e besimit të kompania.
- Operatori Ekonomik duhet të krijojë konceptin, skenarin dhe storyboard-in e spotit televiziv.
- Përpara përgatitjes së videove, operatori ekonomik duhet të prezantojë një ide nëpërmjet një ‘storyboard’, i cili duhet të ketë në përmbajtje ideimin, krijimin dhe skenarin e spotit korporativ.
- Spoti duhet të realizohet në përputhje me standartet dhe teknikat më të avancuara të filmimeve të kësaj natyre dhe duhet të jetë i përshtatshëm për formatin e transmetimit në High Definition.
- Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë dhe 2 (dy) versione të tjera të spotit: versionin 30 sekonda dhe një spot 10 sekonda.
- Për spotin, operatori ekonomik duhet të marri përsipër që pamjet që do të regjistrohen gjatë periudhës së xhirimeve duhet të jenë ekskluzive në pronësi të shoqërisë “Albpetrol” SH.A. Xhirimet duhet të përmbajnë:
  - h. Sekuenca të filmuara me kamera në lartësi nëpërmjet dronit.
  - i. Sekuenca të filmuara në nivelin e syrit apo të tokës.
  - j. Të kenë skena nga objektet kryesore të shoqërisë “Albpetrol” SH.A.

- k. Të jenë një kombinim midis xhirimeve të ndryshme dhe elementeve grafik të animuar.
- l. Muzikë, Audio/narracion shoqërues me copyright;
- m. Spoti duhet të jetë në formatin MPEG 2 me CBR 35 dhe H 264 me CBR 35, me rezolucione 16 \* 9 (1920 x 1080 px)
- n. Regjistrim profesional të zërit. Efektet audio (SFX) dhe kolona zanore duhet të përmbushin standartin teknik sipas parametrave: 48 khz dhe 24 bit depth.
- Efektet audio dhe efektet muzikore në përmbajtje të materialit përfundimtar duhet të jenë të trajtuar posaçërisht për Spotin TV dhe të zotërojnë të gjitha të drejtat e rezervuara të përdorimit të pakufizuar, si në aspektin gjeografik ashtu edhe në aspektin kohor.
- Spoti TV duhet të përmbajë sloganin kryesor, logon zyrtarë dhe websitin zyrtar të shoqërisë “Albpetrol” SH.A, i cili është [www.albpetrol.al](http://www.albpetrol.al).
- Spoti TV duhet të ketë në përbërje të tij tekst përshkrues në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze.
- Operatori Ekonomik duhet të sigurojë të gjithë infrastrukturën e nevojshme për realizimin e Spotit TV: transportin, stafin dhe lejet e xhiritimit në secilat prej pikave të shoqërisë “Albpetrol” SH.A të parapërcaktuara për xhirime.
- Masterat e Spotit TV duhet të dorëzohen në formatin MPEG 2, MP4, me rezolucion 16/9 (1920 x 1080px) në USB ose në Hardisk.

III.5.2. Neni 2 “Qëllimi i ligjit” i ligjit nr.162/2021 “Për prokurimin publik”i ndryshuar parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.5.3. Neni 3 Parime të përgjithshme 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.5.4. Neni 21 Autoriteti ose enti kontraktor 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në

*zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi*

III.5.5. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit.

III.5.6. Në rastin konkret referuar pretendimeve të ankimesit dhe kthimit të përgjigjes së autoritetit kontraktor, KPP vëren se ankimesi ka dështuar të argumentojë se në çfarë mënyre specifikimet teknike të vendosura nga autoriteti kontraktor për videon e përgjithshme korporative çënojnë konkurrencën apo të të cojnë drejt një prodhuesi të vetëm. Nga ana tjetër autoriteti kontraktor ka arritur të argumentojë përse i ka vendosur këto specifikimet për realizimin e videos së përgjithshme korporative duke e lidhur me multifunksionet që ajo do të kryejë duke filluar nga përdorimi në faqen zyrtare të shoqërisë “Albpetrol” SH.A, prezantime në eventet kombëtare e ndërkombëtare ku merr pjesë autoriteti kontraktor si dhe nëse është e nevojshme për transmetime televizive duke qenë pjesë e portofolit prezantues e protokollar të tij. Sa më lart duke qenë se operatori ekonomik ka dështuar të provojë se pse specifikimet e vendosura nga autoriteti kontraktor për këtë rast çënojnë konkurrencën apo të cojnë drejt një prodhuesi të vetëm dhe nga ana tjetër autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigje ka dhënë argumentat e tij mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike KPP gjykon se pretendimi i ankimesit nuk qëndron.

Sa më lart pretendimi i ankimesit nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë

13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos:**

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Optima Communication” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-41494-03-18-2025, me objekt “Shërbim për zhvillimin e strategjisë së komunikimit dhe marketingut me publikun”, me fond limit: 14,873,333.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 03.04.2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Albpetrol.
  2. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Optima Communication” SHPK në procedurën e prokurimit të sipërcituar.
  3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në dokumentet e tenderit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik dhe vendimmarrjes së KSHA-së.
  4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
  5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Optima Communication” SHPK.
  6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

|                       |                         |                    |                       |
|-----------------------|-------------------------|--------------------|-----------------------|
| <b>Nënkryetar</b>     | <b>Anëtar</b>           | <b>Anëtar</b>      | <b>Anëtar</b>         |
| <b>Fioorent Zguro</b> | <b>Kreshnik Ternova</b> | <b>Anila Malaj</b> | <b>Gjergj Mersini</b> |

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**

